

THESARE

MJET FRYMËZIMI DHE UDHËRRËFYES PËR PASTORËT DHE SHËRBYESIT

numri 9 / vjeshtë 2016

Editorial 2

Gëzim Spahija

Roli i Udhëheqjes Frymërore në
Dishepullizim 3

Shane Warren

Dishepullbërja për Kohë në Ndryshim
dhe Kisha në Ndryshim 9

Michael J. Wilkins

Predikim që Realisht Ndryshon
Jetë: Gjashtë Faktorë në
Formimin e Dishepujve 14

Stephen Lim

Bindje e Menjëhershme: Aventura
për t'u Akorduar te Perëndia 19

Rod Loy

Takime Hyjnore 25

Marcia Lednicky

Cikli i Dishepullizimit:
Një Proces pa Mbarim 30

Randy Hurst

Përshtypje nga Konferenca Ballkanike
e të Rinjve 33

Gëzim Spahija

Tema e këtij numri: Dishepullizimi, Mandati i Neglizhuar



Dishepullizimi: Mandati i Neglizhuar

Perëndia e krijoi njeriun sipas shëmbëlltyrës së Tij, dhe e bekoj atë. Zoti iu tha Adamit dhe Evës që të ishin të frytshëm dhe të shumëzoheshin, të mbushnin tokën e ta nënshtronin. Ky plan i Tij u realizua dhe u përsos në Jezusin i cili na la porosinë e Tij, amanetin e Tij: që të bëjmë dishepuj.

Një nga qëllimet për të cilat Perëndia na ka krijuar, është që të jemi të frytshëm duke bërë dishepuj. Jezusi ishte duke kryer vullnetin e Atit ndërsa ishte këtu në tokë, dhe na porosi duke na thënë: “Me të njëjtën dashuri që unë ju desha juve, ta doni njerëzit”, për të transmetuar mesazhin e shpëtimit, të rilindjes, dhe të jetës së përjetshme.

Jeta e Tij këtu në tokë ishte transparente. Ai iu tha dishepujve të Tij një fjalë: **ndiqmëni**. Të bësh dishepuj do të thotë të bësh ndjekës, dhe kjo është një përgjegjësi shumë e madhe, sepse ata jo thjesht do të dëgjojnë, por më shumë do të shikojnë si praktikohet fjala e Zotit në jetën tënde.

Jezusi, në shërbesën e Tij, ishte duke punuar dhe shërbyer me turmat e njerëzve, por në veçanti duke dishepullizuar të dymbëdhjetët, duke punuar me tre persona, por edhe me një të vetëm. Ai bëri dhe la dishepuj, të cilët e vazhduan shërbesën këtu në tokë, dhe këtë kërkon edhe nga ne.

Në Porosinë e Madhe, Zoti Jezus na siguron për suksesin që ne do të kemi në qoftë se jemi me Të, sepse: “Mua më është dhënë çdo pushtet në qiell e në tokë. Shkoni, pra, dhe bëni dishepuj nga të gjithë popujt duke i pagëzuar në emër të Atit e të Birit e të Frymës së Shenjtë, dhe duke i mësuar të zbatojnë të gjitha gjërat që unë ju kam urdhëruar.

Dhe ja, unë jam me ju gjithë ditët, deri në mbarim të botës. Amen” (Mateu 28:18-20). Me fuqinë e Jezusit, ne duhet të bëjmë sa më shumë dishepuj në kishë, por edhe në nivelin e shërbestarëve: sa më shumë pastorë, mësues, ndihmues, dhe misionarë. Kjo është edhe trashëgimia jonë në Krishtin.

Ndonjëherë ndodh që në kishat tona të nënvleftësohet ky urdhërim i lënë nga Perëndia, apo ndodh që t’iu faturohet vetëm atyre që janë duke drejtuar. Por Jezusi e ka thënë shumë qartë tek Mateu 28, që dishepujt do të bëjnë dishepuj; pra, të çdo niveli qofshin, të përfshirë ose jo në shërbesën e Zotit.

Plani i Zotit është që të gjithë ne të vihem në përdorim nga Ai, duke investuar në jetën e njerëzve që ai na ka besuar në kishat tona, por gjithashtu duke investuar edhe për ata të cilët Perëndia do t’i thërrasë në të ardhmen.

Siç punuan misionarët në jetën tonë dhe patën besim tek ne duke na aktivizuar në shërbesë, duke na bërë dishepuj të Jezusit përmes shembullit të tyre, edhe ne duhet të besojmë e investojmë më shumë e të jemi duke bërë dishepuj tanë. Kjo do të jetë shërbesa jonë e mençur. Ndërsa ti shërben si një dishepull i Krishtit dhe bën bashkëpunëtorë, ti po përgatit dishepuj të aftë, të mësuar për të bërë dishepuj.



GËZIM SPAHIJA

Drejtor Ekzekutiv, Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë të Shqipërisë.

THESARE

Numri 9
Vjeshtë 2016

Koordinatorë e projektit: Stephanie Plagenhoef
Përkthyes: Fabian Tozharaku
Redaktues: Skënder Hoxha
Grafika kompjuterike: Lindita Sqapi

Botuar nga:
Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë të Shqipërisë

Në bashkëpunim me:
Life Publishers International

Adresa: K.P. 119 / Kutia 2 / Tirana, Albania
Cel: (+355) 69-406-8956
Email: KTU@icc-al.org



Artikujt e zgjedhur dhe grafika përshtatur nga revista Enrichment - ©Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë, ShBA. Përdorur me leje.

©Life Publishers International. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Roli i Udhëheqjes Frymërore në Dishepullizim

Nga: SHANE WARREN

*Roli i pastorit si një
udhëheqës frymëror në
procesin e dishepullizimit
është i domosdoshëm, në
mënyrë që ky proces të jetë
efikas.*



Dishepullizimi biblik është kthyer në një parullë të ditës në lëvizjen ungjillore moderne. Fatkeqësi sht, në shumicën e rasteve, përveçse parullë dite, nuk është kthyer në asgjë tjetër. Në mes të përkufizimeve tona të shumta dhe metodave të sapozbuluara të dishepullizimit, studimet statistikore tregojnë një rënie alarmante në efikasitetin e kishës moderne për ta arritur njerëzimin e humbur dhe për ta transformuar atë.

Në një studim të botuar më 19 mars 2007 nga Grupi Hulumtues Barna, shkruhet: “Jeta në Amerikë ka ndryshuar shumë që prej vitit 1994, duke pasur ndryshime të mëdha në teknologji, në politikën globale, në zgjedhjet e stileve të jetesës dhe në dinamikën e familjes. Por një konstante e pandryshueshme ka qenë raporti i të personave në moshë madhore të cilët nuk shkojnë në kishë ... 1 nga 3 të rritur (33 për qind) klasifikohet si i pakishëruar – që do të thotë se gjatë gjashtë muajve të fundit, ata nuk kanë marrë pjesë në asnjë lloj shërbese fetare”.

Pa dishepullizim të vërtetë ekziston besimi tek Perëndia, por nuk ka një rendje të sinqertë pas Krishtit. Hiri me kosto të ulët është një armik vdekjeprurës i kishës.

Në mënyrë tragjike, ky studim raporton se më shumë sesa 100 milionë amerikanë nuk shkojnë në kishë. Popullsia e pakishëruar e Amerikës është e barabartë me popullsinë e vendit të 11-të më të madh në botë. Çfarë akuze kundër kishës!

Mungesa e zbulesës në dishepullizimin e vërtetë biblik është diçka shkatërruese për trupin e Krishtit. Jemi fokusuar kaq shumë në fitimin e të konvertuarve sa që nuk kemi bërë aspak punë të mirë në bërjen e dishepujve. Një mori njerëzish dynden në altarët e kishave tona me mendësinë që në qoftë se bëjnë një lutje magjike, ajo do t'i udhëheqë në një ndryshim dramatik të jetës. Ne gëzohemi për reagimet e tyre pozitive, dhe, në njëfarë mënyre, ata janë të bindur nga zëri i fesë se shpëtimi i vërtetë ka ndodhur.

Thirrjet e Jezusit për tek altari ishin ndryshe. Pikëpamja e tij se ç'do të thotë të jesh i shpëtuar ishte shumë ndryshe nga përkufizimi i mekur i kishës moderne. Jezusi e kualifikonte zemrën e vërtetë të pendimit me anë të provës së dishepullizimit.

I riu pasanik vrapoi dhe e ndali Jezusin në rrugë. Kërkesa e tij ishte: “Çfarë duhet të bëj që të trashëgoj jetën e përjetshme?” Zoti iu përgjigj duke i treguar një nga predikimet e Tij të preferuara të shkruara nga Moisiu. Dhe i riu iu përgjigj: “Të gjitha këto i kam zbatuar që nga fëmijëria ime”.

Atëherë Jezusi e rriti standardin e dishepullizimit: “Shit të gjitha ato që ke dhe jepua të varfërve” (Marku 10:17-22). Shkrimi është i qartë; ky i ri pasanik u largua i trishtuar.

I riu pasanik ishte i gatshëm që të bëhej një i konvertuar, por nuk ishte i gatshëm për të paguar çmimin e dishepullizimit. Ai donte një fe që të ishte e leverdishme për stilin e tij të jetesës larg nga sundimi i Krishtit. Dëshira e tij për një fe të leverdishme e la atë në pozitën ku mbetet çdo person i pasinqertë: i trishtuar dhe i brengosur.

Krishterimi pa dishepullizim është krishterim pa Krishtin. Ky lloj dishepullizimi nuk bëhet asgjë më shumë sesa një ide abstrakte, një mit i cili e ka një vend për atësinë e Perëndisë, por e mohon Krishtin si Zotin e gjallë dhe Mjeshtër të jetuarit. Pa një dishepullizim të vërtetë ekziston besimi tek Perëndia, por nuk ka një rendje të sinqertë pas Krishtit. Hiri me kosto të ulët është një armik vdekjeprurës i kishës.

Jezusi e kuptoi fuqinë dhe çmimin që kishte dishepullizimi. Dita pasi Gjon Pagëzori e pagëzoi Jezusin në lumin Jordan (Gjoni 1:35-39), ishte edhe dita kur filloi dishepullizimi i vërtetë i krishterë. Një e nga një, Jezusi zgjodhi 12 burra, për të cilët Ai do të modelonte karakterin e Atit. I parë nga të gjitha përkufizimet fetare të suksesit, Jezusi ishte një dështim total. Ai nuk kishte marrë asnjë kredencial nga organizatat frymërore të kohës së Tij. Nuk filloi asnjëherë ndonjë shkollë biblike, dhe as nuk themeloi ndonjë denominacion. Turma njerëzish morën pjesë në takimet e Tij, por në vend që të paguanin çmimin e përkushtimit në besim, dëgjuesit e refuzuan Atë. Vetëm 12 burra, nga më të përulurit dhe më të thjeshtët e shoqërisë së shekullit të parë, u zgjodhën për modelin e kishës. Pikërisht në këtë model, në modelin biblik, ne gjejmë metodën e vërtetë për të bërë dishepuj.

Ekziston vetëm një qasje për të bërë dishepuj të vërtetë – dhe kjo është mënyra e Jezusit. Ai nuk përdori një program tradicional për të ndikuar me ndryshim jete të jashtëzakonshëm për ndjekësit e Tij të zakonshëm. Ai thjesht iu modeloi atyre çdo ditë, përmes udhëheqjes së Frymës së Shenjtë, zemrën e Atit. Ndërkohë që përballej me çështjet e përditshme të jetës, Ai përdori çdo detaj për t'i mësuar dhe trajnuar këta 12 burra në mënyrë që ata të bëheshin dishepuj të synuar nga plani i Perëndisë. Aq shumë e solli ai shembullin e Atit tek dishepujt e Tij, sa që

mund të thoshte: “Kush më ka parë mua, ka parë Atin” (Gjoni 14:9).¹

Këtu gjendet edhe provimi i hidhur i dishepullizimit. A mundeni ju, si një udhëheqës frymëror, që të bëni të njëjtin pohim për ecjen tuaj të krishterë? A mund të thoni ju: “Kur të më shihni mua, keni parë Atin?”. A jeni ju një reflektim i përditshëm i zemrës së Atit? Përtej programeve të ndryshme apo metodologjive, a e shohin njerëzit karakterin e Perëndisë që punon në ecjen tuaj të përditshme? Fjala *dishepull* në Bibël vjen nga fjala rrënjë “*matheo*” nga greqishtja. Nga kjo rrënjë, ne sot marrim fjalën *matematikë*. Zoti e kuptoi se matematika më e mirë për kishën është dishepullizimi. A ishte efikase pamja që Ai kishte për dishepullizimin? Po. Në javën e parë të kishës së Dhjatës së Re, afërsisht 8 mijë njerëz iu shtuan grupit të besimtarëve.

Shumë kisha pentekostale sot po e minimizojnë rëndësinë e veçorisë pentekostale në dishepullizim. Nga frika se mos i humbasin anëtarët e kishës ose se mos i bëjnë konfuzë njerëzit e pakishëruar, ata e kanë ndaluar manifestimin e Frymës së Shenjtë në shërbesa adhurimi publike. Ata madje guxojnë të mos luten që njerëzit të marrin pagëzimin në Frymën e Shenjtë. Duke e fyer Frymën e Shenjtë, ata zëvendësojnë, në paditurinë e tyre, fuqinë e dishepullizimit me programet e njeriut. Por puna e Frymës së Shenjtë në jetën e një besimtari nuk mund të jetë kurrë e tepruar. Fuqizimi që vjen përmes Frymës së Shenjtë dhe pagëzimi në Të janë të një rëndësie të madhe në procesin e formimit të dishepujve të efektshëm.

Nëse e heqim Frymën e Shenjtë nga procesi i dishepullizimit, humbasim fuqinë e atij procesi.

Jemi fokusuar kaq shumë në fitimin e të konvertuarve saqë nuk kemi bërë aspak punë të mirë në bërjen e dishepujve.

Përgjatë Shkrimit shohim rritjen e kishës të cilësuar me terma të tillë si *i shtonte / iu shtua* (Veprat 2:47; 11:24) dhe *shumoheshin / shumoheshin* (9:31; 12:24). Përse nuk na dalin llogaritë me matematikën tonë të kishës moderne? A mund të jetë fakti që, edhe pse me metodat tona të reja e moderne të rritjes së kishës, ne ende mund të mos e kuptojmë dishepullizimin biblik? Çfarë kërkohet për të ndryshuar me efikasitet jetët e njerëzimit që po lëngon? Fjala e Perëndisë është e qartë në mësimet e saj për sa i përket karakteristikave të dishepullizimit efikas.

Për dishepullizimin është një person

Pa personin e Frymës së Shenjtë, të gjitha metodologjitë e dishepullizimit janë të padobishme. Jezusi i udhëzoi dishepujt e Tij që të “qëndronin në qytetin e Jerusalemit, derisa të visheshin me fuqi nga lart” (Luka 24:49). Në çastin kur Jezusi ua dha këtë udhëzim të rëndësishëm, të pranishëm në atë vend mund të kenë qenë gati 500 vetë (1 Korintasve 15:6). Fatkeqësisht, vetëm 120 persona iu bindën Atij dhe u ngjitën në Dhomën e Sipërme. Ata që ndoqën udhëzimet e Zotit morën një fuqizim të mbinatyrshëm për të qenë dëshmitarë (Veprat e Apostujve 1:8). Ky grup i vogël besimtarësh ktheu qytete përmbys, duroi flakët e persekutimit dhe ua mbylli gojën cinikëve të kohës së tyre. Në asnjë vend nuk lexojmë për ata njerëz të cilët nuk zgjodhën që të shkonin në vendin e fuqizimit.

Pjetri eci me Jezusin për 3 vjet. Ai jetoi, hëngri, fjeti dhe shërbeu me Mjeshttrin. Megjithatë, atë që Jezusi nuk e bëri për Pjetrin në 3 vjet, Fryma e Shenjtë e bëri në një çast. Ai frikacaku që mohoi Birin e Perëndisë përpara një vajze të vogël qëndroi në këmbë Ditën e Rrëshajëve dhe shpalli me guxim besimin e tij. Asgjë nuk i fuqizon dishepujt ashtu siç bën pagëzimi në Frymën e Shenjtë.

Për dishepullizimin është një plan

“Sikurse na zgjodhi në të përpara themelimit të botës” (Efes. 1:4 – gërmat janë bërë të pjerrëta nga autori i artikullit). Perëndia e ka një plan për të bërë dishepuj. Në mënyrë që dishepullizimi në kishën vendore të jetë i suksesshëm, duhet që të ketë një plan, një proces. Metodatat nuk janë të këqija, për sa kohë që ato i nënshtrohen Mjeshtrit. Po ju pastorë, çfarë plani keni për të bërë dishepuj?

Jezusi e pyeti Pjetrin nëse ai e donte Atë. Pjetri iu përgjigj duke pohuar. Në thelb, Jezusi i tha Pjetrit që ta vërtetonte këtë dashuri duke u kujdesur për qengjat e Tij (Gjoni 21:15-17). Zemra e Atit i zbulohet besimtarit përmes procesit të dishepullizimit.

Neglizhimi i të sapolindurve të mbretërisë është vëllavrasje frymërore. Ata duhet me doemos që të ushqehen, dhe duhet të ndihmohen në hapat e tyre drejt pjekurisë frymërore. Madhësia dhe personaliteti i secilës kishë ndryshon nga njëra-tjetra, por në çdo situatë, kisha duhet të bëjë gjithçka që ka në dorë

Dishepullizimi: Përgjigjja ndaj krizës së udhëheqjes

Kudo ku hedhim sytë, gjejmë një krizë në udhëheqje. Uorren Benis (Warren Bennis), themelues i Institutit të Udhëheqjes në Universitetin e Kalifornisë së Jugut, nxjerr në pah se sa e rëndë është kjo krizë.

“Aktualisht njerëzimi përballlet me tri kërcënime të jashtëzakonshme: kërcënimi i zhdukjes nga një aksident apo luftë bërthamore, kërcënimi i një murtaje mbarë-botërore ose i një katastrofe ekologjike, dhe një krizë më e thelluar e udhëheqjes në shumicën e institucioneve tona. Ndryshe nga murtaja apo asgjësimi bërthamor, kriza e udhëheqjes ndoshta nuk do të kthehet në bazë materiale për librin më të shitur apo për filmin më të shikuar, por në shumë mënyra është kërcënimi më urgjent dhe më i rrezikshëm me të cilin përballemi, për shkak se nuk dallohet mjaftueshëm dhe kuptohet shumë pak”.

Ku janë Çërçillat dhe Spërkhënat e shekullit të 21-të?

Në vend të Uajtfildave dhe Ueslive (Whitefield & Wesley), gjejmë 1,500 pastore që largohen çdo muaj nga shërbesa, për shkak të dështimit moral, rraskapitjes frymërore apo të konfliktit në kishat e tyre. Raporti i divorcit në mesin e klerikëve luhatet diku rreth 50 për qind, një nga më të lartët se çdo profesion.

Katër mijë kisha të reja do të mbillen këtë vit në Amerikë, por shtatë mijë do të mbyllen, kryesisht për shkak të mungesës së udhëheqjes. Çfarë po ndodh?

Përgjigjja është e thjeshtë: Ne e kemi futur në qark të shkurtër procesin që Perëndia urdhëroi për të krijuar udhëheqës, pra, dishepullizimin.

Jezusi nuk erdhi vetëm për të vdekur për mëkatet e botës, por gjithashtu për të fituar, trajnuar dhe dashur një familje me individë të nxjerrë nga çdo komb e çdo gjuhë nën qiell. Cila është strategjia e Tij për ta arritur pjesën e dytë të planit të Tij hyjnor? Ai zgjodhi 12 dishepuj, i trajnoi ata për të qenë apostujt e Tij, dhe i dërgoi që të bënin të njëjtën gjë.

Ky është mandati apostolik, si edhe plani kryesor i ungjillëzimit. Nuk ekziston një plan B, as ndonjë rrugë e shkurtër apo ndonjë ide më e mirë që pritet të zbulohet. Ai do të ketë një Nuse, një kishë të lavdishme pa njolla e pa rrudha, dhe do të ndërtohet dishepull përmbi dishepull.

Të punosh për vite me radhë, të derdhësh jetën tënde tek disa njerëz që mund ose mund të mos rezultojnë udhëheqës të mirë, kërkon goxha përkushtim dhe këmbëngulje. Jo vetëm që të duhet t'i zësh besë Perëndisë për të ngritur udhëheqës, por gjithashtu ke nevojë të besosh në procesin e dishepullizimit.

Vendosja e dishepullizimit dhe e trajnimit të udhëheqjes si prioritet kryesor, është një strategji investimi afatgjatë, e cila hera-herës mund të duket e mërzitshme e krahasuar me turmat e mëdha dhe me takimet e rizgjimit që shumë vetë besojnë se janë tregues i një shërbese të suksesshme. Por shërbesat që përpiqen t'i shtojnë njerëz kishës vetëm përmes evenimenteve të mëdha e gjejnë veten vazhdimisht duke kërkuar udhëheqës, duke i reklamuar udhëheqësit, duke dalë për të rekrutuar udhëheqës – për shkak se shumë rrallë evenimentet ngrenë udhëheqës.

Në fund, një trashëgimi e shpejtë përparon rrallë. Megjithatë, investimi i kohës, i parave dhe i përpjekjeve tuaja në mandatin apostolik prodhon një kthim të investimit që vazhdon të rritet në mënyrë të papërcaktuar.

Ata të cilët ia përkushtojnë veten e tyre strategjisë së Zotit do të fitojnë botën, jo me anë të mbledhjes, por me anë të shumëzimit.



RICE BROOCKS është bashkëthemelues i kishave dhe shërbesave Every Nation, dhe pastori kryesor i “Qendrës Bethel për Arritjen e Botës” në Nashville, Tennessee. Ribotuar me leje nga <http://www.everynation.org>.

për ta kthyer në avantazhin e besimtarit të ri vendimin për të ndjekur Krishtin. Tek Isaia 26:18 shpallet: “Jemi ngjizur, kemi ndier dhimbjet, sikur të kishim për të lindur, por ishte vetëm erë”. Kisha është ngjizur dhe e ka fatin “në bark”, por a mos vallë po lindim vetëm erën? Ne i bëjmë të gjitha përpjekjet me përgatitjen e shërbesës dhe me planifikimin, dhe në fund të ditës, i gjejmë duart të zbrazura. Në qoftë se nuk i ndihmojmë foshnjat e mbretërisë me rritjen frymërore, do të zbulojmë që puna jonë ka qenë e pavlerë dhe e padobishme. Dëshira e Perëndisë për

secilin prej nesh është që ne të prodhojmë shumë fryte (Gjoni 15:8). Ku është fryti i punës sonë në Zotin? Për shumë prej nesh, pafrytshmëria jonë vjen si rrjedhojë e mungesës sonë të planifikimit në procesin tonë të dishepullizimit.

Për dishepullizimin është një popull

Pavarësisht se sa e mirë është metodologjia jonë, ajo nuk mund ta zëvendësojë preken njerëzore. Me qëllim që të ndodhë dishepullizimi, besimtarët e thjeshtë të kishës suaj duhet të kenë një vizion për

Kur të krijohet një komunitet, në të cilin pritshmëritë e dishepullizimit besohen dhe praktikohen nga e gjithë bashkësia, atëherë kjo do të ketë një ndikim të suksesshëm tek të konvertuarit e rinj ndërkohë që ata vijnë në kishë.

të. Pastorët nuk e kanë aftësinë për t'i përdorur të dyja duart njëloj, si oktapodi; prandaj, njerëzit në kisha duhet të kenë një zemër për procesin e rritjes frymërore. Në qoftë se trupi i Krishtit nuk e kupton bashkë-komunikimin e tyre, atëherë as formimi frymëror i vërtetë dhe as reformimi nuk kanë për të ndodhur.

Llogaridhënia brenda trupit të Krishtit është një vegël e fuqishme kundër frymës së këtij brezi. Në fakt, bashkimi ka një lloj fuqie shpërthyes. Kur kisha vendore bashkohet me zemrën e ungjillëzimit dhe dishepullizimit, atëherë është e pranishme rritja dinamike. Ne jemi rojtari i vëllait tonë, dhe në rast se i bëjmë bisht përgjegjësisë sonë ndaj njëri-tjetrit në trupin e Krishtit, atëherë kryejmë një mëkat vdekjeprurës kundër vetë trupit tonë.

Dishepullizim do të thotë të ndjekësh disiplinën e dikujt tjetër. Një pjesë e dishepullizimit biblik është disiplina biblike. Kjo është një temë që nuk diskutohet aq shumë nëpër kisha. Prapëseprapë, kisha duhet të ketë kufij të përcaktuar qartë brenda strukturës së organizatës së saj, si dhe brenda strukturës së paprekshme të komunitetit të besimtarëve.

Njerëzit kanë shumë dëshirë që të kenë marrëdhënie të cilat kërkojnë llogaridhënie; ata dëshirojnë t'i përkasin një komuniteti. Kur të krijohet një komunitet, në të cilin pritshmëritë e dishepullizimit besohen dhe praktikohen nga e gjithë bashkësia, atëherë kjo do të ketë një ndikim të suksesshëm tek të konvertuarit e rinj ndërkohë që ata vijnë në kishë.

Njerëzit tuaj janë ajo rrjeta që ju ndihmon t'i mbani peshqit e rinj që kapni. Herë pas here, përdorimi apo keqpërdorimi do të krijojë vrima tek rrjeta. Një peshkatar i mirë i arnon rregullisht rrjetat e tij. Psalmi 133 e thotë qartë se ka vajosje kur ne bashkohemi, dhe pikërisht në bashkëpjesëmarrjen e trupit të Krishtit, Perëndia e urdhëron bekimin që të zbresë mbi ne.

Për dishepullizimin është një çmim i caktuar

Mos u gaboni: Dishepullizimi efikas e ka një çmim, sepse nuk mund të ketë dishepullizim pa kryqin. Një nga tragjeditë e mëdha të kohës sonë është zbukurimi që i bëhet ungjillit për ta bërë atë më të pëlqyeshëm për dëgjuesit. Duke bërë kështu, ne nuk predikojmë aspak ungjillin; por predikojmë një "ungjill tjetër" (2 Korintasve 11:4). Në qoftë se nuk jemi të

kujdesshëm, përpjekjet tona për ta bërë ungjillin më të përshtatshëm e të rëndësishëm për kulturën tonë do ta bëjnë atë, por edhe neve, të pafuqishëm për ta ndryshuar kulturën tonë. Në të kundërt të asaj që thonë disa doktrina, Jezusi nuk e kishte dhe nuk e ka problem që të jetë i përshtatshëm e i rëndësishëm në çdo brez. Ai është "i njëjtë dje dhe sot dhe në përjetësi." (Hebrenjve 13:8).

Mos kini frikë që ta komunikoni çmimin e dishepullizimit, si edhe ta kërkonti atë. Njerëzit duan që të sfidohen. Disa persona mund ta konsiderojnë atë të pavlerë si diçka fetare; por ju do të zbuloni se kur mbartet kryqi i dishepullizimit, ai i shton vlerë dhe vlefshmëri jetës së besimtarit.

Do të ketë periudha kur të qenit dishepull mund të jetë e dhimbshme; megjithatë, nuk është tragjedi të durosh kryqin. Vuajtja e kryqit është fryti i një aleance ekskluzive me Jezu Krishtin. Në rast se krishterimi ynë nuk po e merr më seriozisht dishepullizimin, në qoftë se e kemi zbukuruar ungjillin në pikën e frymëzimit emocional i cili nuk bën kërkesa që të kushtojnë, atëherë e kemi kthyer kryqin e Krishtit në një gjëmë a katastrofë të përditshme e të zakonshme. Kur heqim çmimin që ka ndjekja e Krishtit, heqim gjithashtu sundimin e Tij nga dishepullizimi. Jezusi nguli këmbë që të ishte Zot mbi gjithçka. "Asnjë shërbëtor nuk mund t'u shërbejë dy zotërinjve." (Lluka 16:13).

Ka një çmim për dishepullin e ri, por ka gjithashtu edhe një kosto ndaj udhëheqjes frymërore. Nuk është e lehtë që të merresh me një foshnjë në Zotin. Ashtu siç ndodh me fëmijët e zakonshëm, edhe ata bëjnë një sërë gabimesh dhe bëjnë një mijë pyetje në sekondë. Ka raste kur ne e harrojmë se dikur edhe ne kemi qenë në atë situatë frymërore dhe dikush na ndihmoi për të arritur transformimin tonë frymëror.

Mua dhe bashkëshortes sime, Pamelës, na pëlqen shumë që t'u japim ndihmë besimtarëve të rinj të cilët kanë një ndjenjë qëllimi (parapërcaktimi). Shtëpia jonë mbushet përplot çdo javë me njerëz që janë të etur për ta njohur Perëndinë më shumë dhe për të bërë më shumë për Të. Në fakt, ne takohemi rregullisht me dy grupe: Të Sapoardhurit dhe siç e quaj unë, Takimi im i Shqiponjave. Çdo javë i ftojme besimtarët e rinj dhe personat që kanë ardhur për herë të parë në kishë që të hanë darkë bashkë me ne. Gjithashtu takohemi edhe me Shqiponjat, me njerëz që ndajnë një thirrje për shërbimin e krishterë. Unë dhe bashkëshortja ime derdhim Fjalën e Perëndisë

dhe përvojat tona të jetës brenda tyre. Kjo praktikë është kthyer në burimin e gëzimit tonë më të madh. Si pastor, asgjë nuk e motivon më shumë njeriun tim të brendshëm sesa kur shoh të rinj besimtarë që zgjerohen në kapacitetet e tyre për Perëndinë dhe për shërbimin ndaj Tij. Ne shpesh na pyesin: “Përse i futeni gjithë këtij telashi? Ti je pastori i një kishë të madhe. Nuk ke nevojë të bësh edhe këtë”. Përgjigja ime është: “Nuk mund ta ndryshosh një jetë nga zyra”.

Duhet të jemi të gatshëm, ashtu siç ishte Krishti, për të jetuar me njerëzit tanë. Jezusi tha: “Ju jeni ata që qëndruat me mua në sprovat e mia.” (Luka 22:28). Dishepujt e panë Jezusin në momentet më të dobëta të jetës së Tij. Në formën e tij njerëzore, Jezusi u tundua në të gjitha pikat, ashtu sikurse edhe ne (Hebrenjve 4:15). Ndryshimet dramatike të jetës së dishepujve ndodhën si rrjedhojë e vëzhgimit që ata i bënë Jezusit teksa Ai menaxhonte me sukses paqëndrueshmëritë e jetës.

Në qoftë se nuk i ndihmojmë foshnjat e mbretërisë me rritjen frymërore, do të zbulojmë që puna jonë ka qenë e pavlerë dhe e padobishme.

Për fat të keq, disa pastorë mbeten të paprekshëm për njerëzit e tyre në nivelin personal. Ata fshihen brenda sigurisë që iu ofron zyra e tyre, dhe shfaqen vetëm për një ose dy predikime çdo javë. Si rrjedhojë, njerëzit e tyre (bashkësia) nuk arrijnë asnjëherë të kenë një shikim nga afër të udhëheqjes së Frymës së Shenjtë në jetën e përditshme të bariut të tyre; prandaj, ata nuk kanë një shembull të përshtatshëm se si duhet të përballesh me konfliktet e jetës. Kjo praktikë prodhon pastorë të cilët vetëm iu predikojnë njerëzve të tyre, në vend që të shërbejnë si barinj për ta, duke i çuar drejt më të mirës së Perëndisë për jetët e tyre.

Përse i hymë kësaj shërbese? Për të ndihmuar njerëzit e lënduar dhe për të arritur botën me ungjillin. Mbani mend, Perëndia vajos personin që është në kullotë me delet. Kur Perëndia kishte nevojë për një mbret, Ai nuk shkoi të kërkonte në një zyrë me ajër të kondicionuar. Ai kërkoi në fusha. Ai e kishte syrin tek një bari. Kur Perëndia donte të lajmëronte ardhjen e Birit të Tij, Ai zgjodhi barinj që po kujdeseshin për kopetë e tyre gjatë natës. Për qindra vjet, *Shekinah* (vendbanimi) e pranisë së Perëndisë ishte zhdukur; por kur Ai donte të zbulonte lavdinë e Tij, zgjodhi barinjtë (Luka 2:8, 9).

Jezusi është quajtur “bariu i mirë” (Gjoni 10:11), i cili jep jetën e Tij për delet. Nëse doni vajosje për shërbesë, nëse doni ta shihni lavdinë e Perëndisë të shfaqur, nëse doni që të jeni një pastor si Jezusi, atëherë bëni punën e një bariu. Jetoni me delet tuaja. Ka një çmim për dishepullizimin, por dishepullizimi është i paçmueshëm.

Për dishepullizimin është një pastor

John Maxwell thotë shpesh: “Gjithçka ngrihet dhe bie mbi udhëheqjen”. Personi, plani, njerëzit dhe çmimi i dishepullizimit janë të mira vetëm nëse është po kështu edhe udhëheqja pastorale e kishës. “Kur nuk ka një vizion profetik, populli bëhet i shfrenuar.” (Fjalët e Urta 29:18). Pa një vizionar, nuk ka vizion. Gjithçka të mirë që Perëndia ka bërë mbi tokë, e ka bërë përmes njerëzve që i ishin dorëzuar Atij.


Pastorë, kisha juaj është një reflektim i udhëheqjes suaj. Çelësi për të ecur përpara në vullnetin e Perëndisë është që të gjeni vendndodhjen tuaj. Vlerësojeni veten dhe bashkësinë tuaj duke përdorur kriteret si më poshtë:

1. A është *personi* i Frymës së Shenjtë aktiv në çdo nivel të shërbesës sonë?
2. A kemi një *plan* real e të realizueshëm për formimin frymëror në kishën tonë? A është i qartë ky plan? A mund ta ndjekë udhëheqja jonë lehtësisht atë?
3. A kanë *njerëzit* një vizion për fitimin e shpirtit dhe për procesin e dishepullizimit?
4. A e kupton organizata jonë, dhe a e përballon mirë, *çmimin* e dishepullizimit?
5. A jam unë, si *pastor*, duke dhënë, në mënyrë aktive, shembullin e një dishepulli në ecjen time të përditshme?

Në qoftë se pastorët nuk i udhëheqin njerëzit e tyre me vizion dhe depërtime profetike në vullnetin e Perëndisë, ata nuk do të arrijnë realizimin e synimit që Perëndia ka për kishën e tyre. Njerëzit po presin nga pastorët e tyre që ata të bëhen Jozueu i tyre, për t'i udhëhequr matanë Jordanit. Një pastor nuk mund t'i udhëheqë ata atje ku ai vetë nuk ka ecur. Pastorët duhet ta marrin iniciativën. Roli i pastorit si një udhëheqës frymëror në procesin e dishepullizimit është i domosdoshëm, nëse ky proces duhet të jetë efikas.



SHANE WARREN, pastor në Asambleen e Parë të Perëndisë, West Monroe, Louisiana.

An abstract painting featuring a central, jagged mountain peak in shades of brown and tan, rising from a dark, swirling base. The base is composed of various shades of blue, green, and grey, with circular, vortex-like patterns that suggest a city or a complex, organic structure. The overall style is expressive and textured, with visible brushstrokes and a moody, atmospheric quality.

DISHEPULLBËRJA

për

Kohë në Ndryshim

dhe

Kisha në Ndryshim

Nga: **MICHAEL J. WILKINS**

Ndërsa qëndroj mbi një rrëpire

nga ku duket oqeani Paqësor afër shtëpisë sonë në Kaliforninë Jugore, shoh vijat e dallgëve që formohen në largësinë e horizontit. Këto valë që më në fund përplasen pranë bregut, sot janë më të mëdha se zakonisht.

Moti është me diell dhe deti i qetë këtu ku qëndroj unë. Por kontrollova parashikimin e motit, dhe zbulova që këto dallgë janë krijuar shumë ditë më parë dhe mijëra kilometra larg në një cep të Zelandës së Re.

Për të bërë sërf siç duhet mbi këto valë, më duhet të di sa më shumë që të jetë e mundur rreth madhësisë, forcës, drejtimit dhe shpejtësisë së tyre.



Dallgët në oqean dhe në kishë

Në dekadën e parë të shekullit të 21-të, shumë dallgë të praktikave, trilleve dhe stileve të ndryshme vazhdojnë të përplasen mbi kishën. Ashtu siç ndodh me valët e oqeanit, shpesh janë forca të cilat vijnë nga vende e kohë shumë të largëta ato që kanë sjellë dallgët e problemeve të kishës, që kanë ndikimin e tyre tek ne sot. Për të bërë sërf siç duhet mbi to, na duhet të dimë sa më shumë që të jetë e mundur rreth forcave që i formuan ato dhe mënyrës sesi ndikojnë tek ne.

Në Amerikë, në vijim të Luftës së Dytë Botërore, lëvizja e shërbesave që kërkonin të dilnin jashtë mureve të kishave i dha hov disa organizatave të ndryshme, si: Navigators, Campus Crusade for Christ (në Shqipëri u quajt Instituti Jeta e Re), InterVarsity, si dhe Billy Graham Evangelistic Association. Këto organizata revolucionarizuan misionin ungjillëzues dhe misionin në universitete. Gjatë viteve '60 dhe '70, lëvizja "Jezusi" i transformoi radikalisht mënyrat tradicionale të shprehjes së adhurimit. Vitet '80 dhe '90 panë ardhjen e lëvizjes "kërkuesit" bashkë me megakishat të cilat arritën të prekin ata njerëz të cilët më parë as nuk e kishin shkelur pragun e kishave tradicionale. Në vitet '90 dhe në dekadën e parë të shekullit të 21-të, ne jemi dëshmitarë të lëvizjes së formimit frymëror. Kjo lëvizje shkon përtej kufijve klerikalë për të ndikuar në kishat kryesore, në kishat biblike, karizmatike dhe në ato që janë në zhvillim me anë të kërkimit për një natyrë frymërore domethënëse.

Secila prej këtyre lëvizjeve ka krijuar një forcë që e ndikon kishën e sotshme. Zbulojmë shumë dallgë të ndryshme të dishepullizimit dhe dishepullbërjes që "përplasen" mbi kishën. Dishepullbërja nuk është një dukuri unike, e as e kohëve të fundit. Ajo e pati fillësën gati dy mijë vjet më parë kur Jezusi thirri burra dhe gra, duke iu thënë: "Më ndiqni".

Por ka edhe forca të tjera sot që e ndikojnë dishepullbërjen në kishë ashtu siç e njohim ne. Termat *dishepullizim* dhe *dishepullbërje* janë shprehje të afërta, që i referohen rritjes si një dishepull i Jezusit dhe ndihmesës dhënë të tjerëve për t'u rritur si dishepuj të Jezusit. Secili prej nesh ka koncepte të shumëllojshme rreth dishepullizimit dhe dishepullbërjes, të cilat janë të influencuara nga përvojat tona.

Traditat dishepullizuese dhe dishepullbërëse

Dallgët e shumta me materiale për dishepullizimin që kanë pushtuar kishën këto 60 vitet e fundit, në shumë raste, kanë bërë që sot njerëzit të ndihen më konfuzë se kurrë më parë kur bëhet fjalë për të kuptuar se çfarë do të thotë të jesh një dishepull i Jezu Krishtit. Këto tradita u zhvilluan nga një dëshirë e mirë për të qenë më të ngjashëm me dishepujt e Jezusit në Dhjatën e Re. Megjithatë, shpeshherë ato përqendrohen kaq rigorozisht tek praktikrat e tyre të veçanta saqë vetëm një pakicë elitare mund t'i përkushtohet atyre.

**Një dallgë e re dhe e fuqishme
dishepullizimi përplasen në brigjet
e kishave tona, ne kemi privilegjin
që t'i ndihmojmë njerëzit me
njohurinë si të bëjnë sërf në
mënyrë efikase mbi to.**

Nxënësi. Disa persona nxjerrin në pah idenë se një dishepull është i përkushtuar ndaj studimit intensiv të Biblës. Një dishepull është i përfshirë aktivisht në kohën personale të devocionit, në mësimin përmendësh të Biblës dhe në studimin e Biblës, duke e bërë një zakon të rregullt në jetën e tij. Kjo nënkupton se një i krishterë bëhet dishepull kur është i përkushtuar ndaj mësimi të Fjalës së Perëndisë dhe vënies në zbatim të saj.

I zotuari. Disa të tjerë nënvizojnë idenë se një dishepull është i zotuar ndaj Krishtit. Ai e ka refuzuar stilin e jetesës sipas botës. Kjo do të thotë se një i krishterë është një dishepull kur ai e mohon realisht vetveten, mbart kryqin e tij, dhe ndjek aktivisht Jezusin për çdo ditë.

Punëtori. Të tjerë akoma shpallin idenë se një dishepull është i përfshirë aktivisht në shërbimin e krishterë. Shërbimi i tij e dallon atë nga të krishterët sa për emër, të cilët thjesht janë pjesë sipërfaqësore e kishës apo e një grupi. Kjo nënkupton se një i krishterë bëhet dishepull kur ai është një punëtor aktiv për Krishtin.

Mentori. Disa persona janë të përfshirë në marrëdhënie një për një, në të cilat një i krishterë më i pjekur dhe më i madh në moshë i dishepullizon ata. Kjo shpesh quhet mentorim. Shumë njerëz besojnë se personat që janë të përfshirë në marrëdhënie të tilla mund të thonë se kanë përjetuar dishepullizim të vërtetë.

Grupi i vogël. Grupet e vogla janë një nga mjetet më efikase për të ndihmuar në rritjen e të krishterëve, sepse aty mund të mësojmë nga shembujt e të tjerëve, të ndajmë jetën tonë me të tjerët dhe të jemi llogaridhënës tek të tjerët për rritjen që dëshirojmë. Shumë vetë sugjerojnë idenë se meqenëse Jezusi dishepullizoi një grupim me një numër të vogël ndjekësish, atëherë dishepullizimi i vërtetë ndodh kur një person është i përfshirë në një grup të vogël.

Një përkufizim për dishepullizimin

Secila prej këtyre pikave ka të vërtetë brenda sepse të gjitha promovojnë rritjen në jetën e krishterë. Megjithatë, ato shpesh janë përkrahur gabimisht si mënyra që individit të bëhet dishepull. Shpeshherë është mbështetur ideja se pasi jeta e një të krishterit karakterizohet nga një ose më shumë nga këto përkushtime, atëherë ai bëhet dishepull.

Mrënja e shumicës së konfuzionit në kohën tonë është ngatërrimi që i bëhet dishepullizimit si një fazë e dytë në jetën e krishterë.

“Të gjithë dishepujt janë të krishterë, por jo të gjithë të krishterët janë dishepuj”, është një shprehje që ta zë veshi në disa grupe njerëzish. Sipas këtij këndvështrimi, dishepullizimi ekziston për një grup të krishterësh që janë elita, për ata persona që janë më të përkushtuar ose ata që janë të trajnuar në mënyrë më të veçantë.

Por kjo nuk ishte ajo që Jezusi donte që ne të kuptonim në lidhje me dishepullizimin dhe dishepullbërjen. Një nocion më i saktë shihet tek Porosia e Madhe, ku kuptojmë se një person që i beson Jezusit bëhet dishepull që në konvertim. Jezusi tha se duhet të bëjmë dishepuj të gjitha kombet (Mateu 18:18-20), dhe jo të bëjmë dishepuj të krishterët. Pra, në momentin që personi beson tek Jezusi dhe merr jetën e përjetshme, ai bëhet një dishepull i Jezusit. Jeta e krishterë e vazhdueshme, për të gjithë besimtarët, është dishepullizimi.

Prandaj, të gjithë besimtarët e vërtetë janë dishepuj të Jezusit; çështja është a janë dishepuj të bindur apo të pabindur. Për më tepër, në këtë kuptim më të përgjithshëm, dishepullbërja nuk është vetëm një aspekt i misionit të kishës; por përfshin gjithçka që kisha bën. Dishepullbërja është shërbesa e kishës për t'i ndihmuar besimtarët që të rriten në dishepullizim ndaj Jezusit.

Mbizotërimi i elitizmave në shumë prej traditave tona shpjegon se përse disa njerëz janë të irrituar në jetën e tyre të krishterë. Një koncept dy-nivelësh i jetës së krishterë promovon plogështinë në mesin e atyre të cilët ende nuk kanë vendosur që të jenë të përkushtuar. Kjo sugjeron se niveli më i lartë i përkushtimit lihet fakultativ, jo i detyrueshëm. Në botën e përditshme të shumë prej të krishterëve kjo do të thotë se përkushtimi ndaj të qenit si Krishti është diçka opsionale.

Theksi që i është vënë dishepullizimit dhe dishepullbërjes në 60 vitet e fundit është fokusuar në fragmente të veçuara dishepullizimi në Shkrim ose në tema të veçanta të dishepullizimit biblik për të ofruar shërbesa të specializuara. Megjithatë, shpeshherë ky specializim bëhet në kurriz të një portreti të plotë biblik të dishepullizimit. Më poshtë do të gjeni një përkufizim më të plotë se çfarë do të thotë të jeni një dishepull i Jezu Krishtit:

Dishepullbërja nuk është vetëm një aspekt i misionit të kishës; por përfshin gjithçka që kisha bën.

Dishepullizim do të thotë të jetojmë të bashkuar me Jezu Krishtin, të rritemi në pajtim me shëmbëllimin e Tij, ndërkohë që Fryma na transformon nga brenda jashtë, të jemi të ushqyer brenda një komuniteti dishepujsh të cilët janë të angazhuar në atë proces të përjetshëm dhe të ndihmojmë të tjerët që ta njohin Jezusin dhe të bëhen si Ai.

Elementet thelbësore të dishepullizimit për një kishë dishepullbërëse

Duke pasur në mendje këtë përkufizim, mund të eksplorojmë vetitë e mëposhtme thelbësore të dishepullizimit biblik dhe të dishepullbërjes, të cilat duhet t'i karakterizojnë përpjekjet tona për të zhvilluar një shërbesë dishepullbërëse.

Dishepullizimi duhet të jetë i rrënjosur në një marrëdhënie personale e të kushtueshme me një Shpëtimtar që na kërkon neve. Jeta e re që vjen në ripërtëritje pati një kosto për Jezusin, dhe ajo na kushton edhe neve. Megjithëse nuk është diçka të cilën mund ta blejmë, ajo gjithsesi është e kushtueshme. Çmimi është jeta: jeta e Jezusit dhe jeta jonë. Çmimi i jetës së Krishtit u pagua në vdekjen e Tij mbi kryq. Ai erdhi që të bënte të shëndetshëm për mbretërinë e Tij, ata persona të cilët ishin të sëmurë nga ana frymërore. Kjo iniciativë mund të përmbushej vetëm përmes dënimit që Ai pagoi për mëkatet tona, duke e treguar dashurinë në veprën e shpagimit mbi kryq. Ai dha jetën e Tij në mënyrë që ne të kemi jetë (1 Korintasve 6:19,20; Marku 10:45).

Çmimi për ne gjithashtu është jeta jonë. Edhe pse vdekja e Jezusit mbi kryq është unike, edhe ne e humbasim jetën tonë përmes mbartjes së kryqit tonë. (Mateu 16:24-26).

Dishepullbërja fillon me një ungjillëzim të qëllimshëm i cili i sfidon njerëzit që të llogarisin koston e pranimit të thirrjes së Jezusit për një jetë në mbretërinë e Perëndisë, e cila i përgatit ata që të angazhohen në transformimin personal dhe ta presin atë si pjesë normale të jetës së krishterë.

Dishepullizimi duhet të fillojë me një identitet të transformuar dhe të orvatet drejt këtij identiteti në Jezusin.

Që prej çastit të shpëtimit, Perëndia na shikon ndryshe. Ne lindim në një identitet të ri si fëmijët e Tij (Gjoni 1:12,13). Jemi krijesa të reja në Krishtin (2 Korintasve 5:17). Po transformohemi në shëmbëllimin e Krishtit (2 Korintasve 3:18) dhe po konformohemi (Romakëve 8:29) ndaj shëmbëllimit të Tij, ndërkohë që Krishti po formohet në ne (Galatasve 4:19).

Identiteti ynë si dishepull i Jezusit ka ndikim në të gjithë qenien tonë, përfshi këtu edhe mënyrën se si e shohim veten, se si ndërveprojmë me Perëndinë dhe mënyrën se si ndërveprojmë me të tjerët. Kishat dishepullbërëse duhet t'i ndihmojnë të krishterët, të rinj dhe të vjetër, që të gjejnë identitetin e tyre, duke qenë dishepuj të Jezusit, në marrëdhëniet e tyre në shtëpi, në vendin e punës, në komunitet dhe në kishë.

Dishepullizimi duhet të iniciohet dhe të fuqizohet nga Fryma e Perëndisë. Fryma e Perëndisë inicion jetën frymërore që pasoi përrurimin që Jezusi i bëri mbretërisë së Perëndisë (Gjoni 3:5, 6). Ky fenomen është përshkruar nga perspektiva të ndryshme nga autorë të ndryshëm të Dhjatës së Re: "rilindje" (Titit 3:5); "rilind" dhe "ngjallje" (1 e Pjetrit 1:3,23); ringjallje frymërore (Romakëve 6:13; Efesianëve 2:5) dhe "krijesë e re" (2 Korintasve 5:17; Efesianëve 2:10); dhe "fara" e Perëndisë në ne (1 e Gjoni 3:9).

Pasi Fryma na jep jetë të re, ne jemi persona të ndryshuar. Puna e mbinatyrshme e Perëndisë, thellë brenda shpirtave tanë, rrënjos jetë të re frymërore në ne, dhe që prej atij momenti, drejtimi i jetëve tona vendoset për nga Perëndia, ndërkohë që Fryma fillon të prodhojë jetë të re, jetën e Jezusit, në ne.

Ungjilli i Gjoni na jep tri karakteristika të dishepullizimit të fuqizuar nga Fryma, që iu japin drejtim shërbesave tona dishepullbërëse:

1. **Të qenit të çliruar nga gënjeshttrat e kësaj bote me anë të së vërtetës së Jezusit** (Gjoni 8:31,32). Kjo liri është aftësia e fuqizuar nga Fryma për të bërë atë që është e mirë dhe e drejtë, aftësia për të zgjedhur Perëndinë, dhe për t'u çliruar nga robëria e mëkatit. Dishepullbërje do të thotë të ndihmojmë dishepujt që të refuzojnë gënjeshttrat e botës rreth vlerave dhe qëllimeve tona. Gjithashtu na ndihmon edhe ne që të gjejmë lirinë për ta jetuar jetën në atë mënyrë që Perëndia e bëri për ta jetuar, duke dëgjuar vazhdimisht të vërtetën e Jezusit rreth realitetit.

2. **Të qenit të dashur nga Jezusi do të thotë që të duam si Jezusi** (Gjoni 13:34,35). Kjo dashuri është shfaqur kur bëjmë një përkushtim pa kushte karshi njerëzve të papërsosur për t'i çuar marrëdhëniet tona drejt qëllimit të menduar të Perëndisë. Dishepullbërja i ndihmon dishepujt që ta shprehin këtë dashuri në martesat e tyre, në prindërimin e tyre dhe në marrëdhëniet e tyre brenda kishës dhe në botë. Duke i ndihmuar dishepujt që të përjetojnë dashurinë e Jezusit, ne i aftësojmë ata që të duan të tjerët.

Në dekadën e parë të shekullit

të 21-të, shumë dallgë të praktikave, trilleve dhe stileve të ndryshme vazhdojnë të përplasen mbi kishën.

3. **Të prodhojmë frytin e të qenit të bashkuar me Jezusin** (Gjoni 15:7,8). Transformimi ynë i vazhdueshëm në shëmbëllimin e Krishtit vjen përmes frytit të Frymës (Galatasve 5:22,23). Fryma e Perëndisë është veprimtari kryesor i fuqizimit të dishepullizimit tonë te Jezusi. Kishat dishepullbërëse i mësojnë njerëzit si të ecin në fuqinë e Frymës, në mënyrë që jetët e tyre të bulëzojnë frytin e Frymës dhe frytin e drejtësisë së perëndishme (Filipianëve 1:11; Kolosianëve 1:10).

Dishepullizimi duhet të udhëhiqet vazhdimisht nga Fjala e Perëndisë. Kishat dishepullbërëse i ndihmojnë njerëzit që të përvetësojnë përkushtime radikale ndaj autoritetit të Fjalës së Perëndisë si e vërteta absolute rreth realitetit. Kjo gjë nuk është thjesht ngulitja mirë në mendje e të vërtetës, por është ndërthurja e të vërtetës me natyrën tonë në mënyrë të tillë që ajo të shprehë botëkuptimin tonë, të karakterizojë vlerat tona dhe të përcjellë të gjithë stilin tonë të jetesës.

Ndërsa iu mësojmë Fjalën e Perëndisë njerëzve, i pajisim ata që ta krahasojnë Fjalën e Perëndisë me vlerat e botës, që të mund ta ndjekin me bindje Jezusin në të gjitha rrethanat (Mateu 28:20).

Dishepullizimi duhet të jetë një proces i cili zgjat gjatë gjithë jetës.

Për shkak se njerëzit janë të krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë, ata janë si Perëndia dhe e përfaqësojnë Perëndinë si asnjë krijesë tjetër (Zanafilla 1:27-31). Shëmbëlltyra e Perëndisë është në natyrën tonë. Është thelbi ynë, mendërisht, moralisht, frymërisht, si qenie në marrëdhënie, dhe jo nga diçka që kemi apo që bëjmë. Mëkati e shpërftyroi shëmbëlltyrën e Perëndisë në ne duke ndikuar në çdo aspekt të shëmbëllimit tonë si Ai, e megjithatë restaurimi fillon me shpengimin tonë në Krishtin (shih Kolosianëve 3:10). Prandaj, kishat dishepullbërëse i ndihmojnë besimtarët që të zhvillohen në çdo aspekt të jetës së tyre, duke i ndihmuar të kalojnë me qëllim përmes dimensioneve dhe etapave të jetës në mënyrë që të rriten vazhdimisht në shëmbëlltyrën e Tij. Dishepujt e Jezusit kanë si synim që të bëhen dishepuj edhe më të plotë në çdo fushë të jetës së tyre. Unë pata një konvertim radikal tek Jezusi dhe lashë pas një jetë ku mbizotëronte droga dhe kërkimi i kënaqësive. Zbulova që jeta ime si dishepull i Jezusit më ndihmoi të bëhesha personi që duhet të isha, një njeri i krijuar sipas shëmbëlltyrës së Perëndisë. Përkushtimi im ndaj Krishtit vazhdon që të ndikojë çdo fushë të jetës sime, përfshirë këtu martesën dhe familjen time, kënaqësinë që gjej në atë që ka krijuar Perëndia teksa bëj sërë ose ngjitem në një mal, ose në rritjen time duke i shërbyer Jezusit në profesionin tim.

Dishepullizimi duhet të kultivohet në komunitetet e besimit. Secili dishepull ka një marrëdhënie personale me Krishtin e cila ndihmon me transformimin në shëmbëlltyrën e Tij. Kjo ma-

Dishepullbërja dhe Programet e Dishepullizimit

Programet e dishepullizimit mund të jenë të dobishme sepse ato ofrojnë metoda dhe rezultate të prekshme. Kur programet rezultojnë efikase duke i ndihmuar njerëzit që të përftojë njohuri, ose duke i bërë qëndrimet të patundura, ose duke prodhuar udhëheqës të dëshiruar, atëherë ato mund të përdoren vazhdimisht me njerëz të ndryshëm në ambiente të larmishme.

Por programet gjithashtu mund t'i joshin pastorët që t'i zëvendësojnë metodat dhe format me njerëz. Shpesh programet fokusohen tek sjelljet e jashtme si një mënyrë për të vlerësuar rritjen. Kjo qasje për masën

(pa karakteristika të veçanta) ndaj dishepullbërjes pretendon që të gjithë të duken saktësisht si modeli që është parashtruar në programin tonë të posaçëm. Ne presim që në përfundim njerëzit të paraqiten sipas asaj që programi ynë shpjegon.

Në qoftë se programet ndihmojnë, atëherë duhet t'i përdorim. Por duhet të jemi të kujdesshëm që të mos përdorim një program i cili mund të shkatërrojë natyrën unike të njerëzve, apo që mund të shërbejë si një zëvendës për shembullin e gjallë të Jezusit në jetët e njerëzve.

MICHAEL J. WILKINS, San Klement, Kaliforni

rrëdhënie personale duhet të ushqehet (rritet) brenda dy komuniteteve parësore të besimit: në familjen frymërore dhe në familjen biologjike.

Familja frymërore është kisha. Hyrja në kishë bazohet tek përjetimi i lindjes së re (Mat. 12:46-50; Gjoni 1:12,13; Mat. 16:18). Vëllezërit dhe motrat në Krisht kanë nevojë për njëri-tjetrin, për një komunitet frymëror të besimit, për të nxitur rritjen e tyre, si edhe Trupin në tërësi (Efesianëve 4:11-13; Hebrejve 10:24,25).

Familja biologjike vazhdon të luajë një rol kryesor në programin e Perëndisë. Martesa është një marrëdhënie, në të cilën burrat dhe gratë, në mënyrë të ndërsjellë ushqejnë transformimet e njëri-tjetrit. Roli prindëror është projektuar për t'i ushqyer fëmijët që të njohin vullnetin e Perëndisë për jetët e tyre dhe për t'i ndihmuar ata që të rriten si persona të plotë që reflektojnë shëmbëlltyrën e Krishtit (Efesianëve 5:22 deri 6:4).

Një kishë dishepullbërëse e pranon përgjegjësinë e saj për t'i pajisur familjet në mënyrë që bashkëshortët të mund të ushqejnë njëri-tjetrin dhe që prindërit të mund të ushqejnë fëmijët e tyre. Më pas, përgjegjësia e familjes është që të trajtojë brezin e ri të udhëheqësve brenda kishës (shih 1 Timoteut 3:4,5; Titit 1:6,7).

Dishepullizimi zhvillohet brenda familjes frymërore dhe familjes biologjike. Kishat

dishepullbërëse i bashkojnë këto dy familje dhe i ndihmojnë ato që të punojnë për të mbështetur dhe forcuar njëra-tjetrën.

Dishepullizimi duhet të kryhet duke qëndruar përkohësisht në botën tonë të përditshme e cila po na vëzhgon. Në këtë jetë, i krishteri është një kalimtar, një banues i huaj (Psalmi 39:12). Krijimi pret ripërtëritjen e tij, dhe rënkton nën robërinë e mëkatit dhe të prishjes (Romakëve 8:19-22).

Megjithatë, dishepujt e rilindur janë çliruar nga vdekja dhe nga mëkati; transformimi ynë ka filluar tashmë. Prandaj, ne nuk jemi të kësaj bote; qytetaria jonë është në qiell (Filipianëve 3:20), dhe ne jemi të huaj dhe shtegtarë në këtë botë (1 e Pjetrit 2:11).

Gjithsesi, qëllimi ynë është ta përparojmë atë ungjill që na ka shpenguar dhe transformuar, të jemi kripa dhe drita në një botë të errët e të kalbur dhe të jetojmë ashtu siç Perëndia dëshiron që të jetojmë përpara një bote që vështron me vëmendje (shih Gjoni 17:15-21).

Komunitetet e besimit janë vende ku besimtarët mblidhen për t'u forcuar e pajisur. Rritja dhe transformimi që ne përjetojmë na aftëson të jetojmë me efikasitet si dishepuj të Jezusit në këtë botë. Transformimi ynë na aftëson që të jetojmë si shtegtarë në botë, dhe të sillemi "mirë ndër paganë, që ... të përlëvdojnë

Perëndinë ... për shkak të veprave (tona) të mira" (1 Pjetrit 2:12).

Kishat dishepullbërëse i ndihmojnë dishepujt e transformuar që ta mbartin ungjillin dhe ta ilustrojnë atë me shembuj në aktivitetet e tyre të përditshme, duke i ofruar jetën e mbretërisë së Jezusit një bote që po vdes pa të.

Dishepullbërja nuk është thjesht një program tjetër, por një transformim

Privilegji i jashtëzakonshëm që kemi si të krishterë është që të ecim si dishepuj të Jezusit dhe të transformohemi vazhdimisht në shëmbëlltyrën e Tij ndërkohë që rritemi në Të. Fryma e Shenjtë ende edhe sot vepron duke i thirrur njerëzit që të ndjekin Jezusin. Detyra jonë e gëzueshme është që t'i modelojmë shërbesat tona për t'i shërbyer Atij për këtë qëllim.

Ky nuk është thjesht një program tjetër alternativë (shih shtojcën anash: Programet e dishepullbërjes dhe të dishepullizimit). Dishepullbërja është thelbi i çdo gjëje që ne bëjmë. Dishepullbërja është shprehja e mënyrës se si Perëndia i pajis dhe i transformon të krishterët për këtë jetë përmes shërbesës së kishës. Ndërkohë që një dallgë e re dhe e fuqishme dishepullizimi përplasat në brigjet e kishave tona, ne kemi privilegjin që t'i ndihmojmë njerëzit me njohurinë si të bëjnë sërf në mënyrë efikase mbi to. Kishat dishepullbërëse ndihmojnë njerëzit e zakonshëm, të cilët po transformohen si dishepuj të Jezusit, që të jenë dritë në errësirë dhe të jenë shembuj të gjallë të shpresës së transformimit, për të cilën bota jona ka nevojë në mënyrë të dëshpëruar.

Kishat dishepullbërëse i ndihmojnë dishepujt e çdo moshe dhe të çdo etape rritjeje që të mësojnë si të ecin me Jezusin dhe si të transformohen prej Tij në çdo fushë të jetës së tyre.



MICHAEL J. WILKINS, Ph.D., është pedagog i

gjuhës dhe i letërsisë së Dhjatës së Re dhe rektor fakulteti në Departamentin Talbot të Teologjisë në Universitetin Biola në qytetin La Miranda, Kaliforni. Midis librave që

ai ka shkruar, veçojmë: *Following the Master: A Biblical Theology of Discipleship* (Duke ndjekur mjeshtër: Një teologji biblike e dishepullizimit) (Zondervan, 1992), *In His Image: Reflecting Christ in Everyday Life* (Në Shëmbëlltyrën e Tij: Duke reflektuar Krishtin në jetën e përditshme) (NavPress, 1997), dhe "Mateu", komentari biblik për zbatim (Zondervan, 2004).

PREDIKIM QË REALISHT NDRYSHON JETË: Gjashtë Faktorë në Formimin e Dishepujve

Nga: **STEPHEN LIM**

Më poshtë do të mund të gjeni gjashtë faktorët kryesorë të cilët e mundësojnë predikimin që të ndryshojë jetë dhe t'i transformojë besimtarët për t'i kthyer në dishepuj që rriten.

Problemi i vetëm më i madh në komunikim”, ka shkruar dramaturgu Xhorxh Bernard Shou, “është iluzioni se komunikimi ka ndodhur”. Fatkeqësisht, kjo përfshin edhe predikimin. Barna ka zbuluar se një anëtar i zakonshëm kishe nuk arrin ta mbajë mend temën e predikimit as dy orë pasi shërbesa ka mbaruar.¹

Nëse është kështu, atëherë vetëmashtimi, të cilit i referohet Shou, është tepër i përhapur në mesin e komunikuesve të krishterë. Një tjetër anketë për anëtarët e kishës në lidhje me perspektivat e tyre mbi dhënien e mesazhit zbuloi se shumë rrallë predikimet prodhonin ndryshim në jetët e tyre.² Rezultatet e këtyre dy anketave kanë lidhje me njëra-tjetrën: Nëse individët nuk e mbajnë mend mesazhin, ata nuk mund ta vënë atë në zbatim.

Pjesërisht si rezultat i predikimeve të dobëta, grupet e vogla dhe disiplinat frymërore kanë fituar popullaritet si alternativat më të preferuara për rritje në dishepullizim. E megjithatë, apostulli Pal, duke përdorur fjalë shumë të qarta, shpall rolin kyç që ka predikimi në procesin e dishepullbërjes. Ai nxit birin e tij në besim, Timoteun: “prediko fjalën, ngul këmbë me kohë e pa kohë, bind dhe qorto, këshillo me çdo zemërgjerësi e mësim” (2 Timoteut 4:2). Ndërkohë që ne i çojmë mjetet shtesë të cilat na ndihmojnë që të formojmë dishepuj, për t’iu bindur thirrjes së Perëndisë, na duhet të gjejmë mënyra për të shpallur me efikasitet Fjalën.

Predikimi historikisht ka luajtur një rol të fuqishëm në formimin e dishepujve. Sërish edhe sot mund të bëjë të njëjtën gjë. Predikimi efikas ndihmon në “ripërtëritjen” e mendjes sonë (Rom. 12:2), duke mundësuar ndryshime në perspektivat, prioritetet dhe praktikat tona. Pra, për ta përmbledhur, predikimi prodhon ndryshim jete. Por, çfarë i ka ndodhur predikimit? Shpesh anëtarët e kishës as nuk mund ta mbajnë mend mesazhin, e jo më ta vënë atë në zbatim.

Më poshtë do të mund të gjeni gjashtë faktorët kryesorë të cilët e mundësojnë predikimin që të ndryshojë jetë dhe t’i transformojë besimtarët për t’i kthyer në dishepuj që rriten. Katër të parët janë më të lehtë për t’u aplikuar nga predikuesit, ndërsa dy të

fundit kërkojnë zakonisht më shumë kohë për të përfutur aftësitë dhe mprehtësinë e nevojshme.

KOORDINONI TEMA PËR TË MËSUAR

Besimtarët të cilët marrin pjesë në disa takime të krishtera në javë marrin një sërë nxitjesh. Gjatë predikimit të së dielës në mëngjes mund të dëgjojnë tre ose katër pika të mira. Më pas, në orën e Biblës ata marrin pika të tjera mbi një temë që është e ndryshme nga ajo e predikimit. Gjatë shërbesës së pasdites të dielës, në shërbesë gjatë javës, në grupin e vogël, ose në kohë miqësie, ata do të dëgjojnë ose studiojnë më shumë pika mbi tema të tjera. Sa pika mund të dëgjojnë në muaj një anëtar i zakonshëm i kishës? Lehtësisht me dhjetëra, por me shumë mundësi, më tepër se aq.

Sa prej këtyre pikave vë në zbatim një besimtar i zakonshëm? Për shumëkënd, realiteti është: *asnjë*. Të mbingarkuar me një numër të madh temash dhe pikash, besimtarët nuk arrijnë as t’i mbajnë mend shumicën e temave që dëgjojnë, e jo më të vënë në zbatim pikat në jetët e tyre. Nëse pastorët do të bënin një anketë për anëtarët e kishës mbi pikat kryesore që ata mbajnë mend nga predikimi i muajt të kaluar si dhe të anketojnë ata që kanë filluar t’i implementojnë në jetët e tyre, atëherë do të zbulojnë se kanë kujtuar pak dhe kanë vënë në zbatim edhe më pak.



Disa kisha kanë mësuar ta koordinojnë mesazhin e të dielës në mëngjes me temën e mundësive të tjera të mësimit gjatë javës. Gjatë këtyre takimeve më të vogla, udhëheqësit e zhvillojnë më tej temën dhe anëtarët e diskutojnë atë, nxjerrin zbatime personale dhe praktikojnë llogaridhënie të ndërsjellë. Kjo i lejon anëtarët që të fokusohen çdo javë te një mesazh parësor. Për më tepër, nëse një kishë merr disa javë për ta zhvilluar një temë të caktuar, atëherë anëtarët do të kenë më tepër kohë për të përfunduar dhe aplikuar të vërtetën në jetët e tyre. Jo të gjitha temat kërkojnë një trajtim të zgjatur. Për larmshmëri, disa tema mund, dhe në fakt duhet, të përcillen në një predikim të vetëm.

Disa kisha madje kanë shkuar një hap më tej duke koordinuar temat, kur është e përshtatshme, në të gjitha grupet e moshave që kanë. Duke marrë temën e përbashkët, ata sigurojnë pyetje dhe aktivitete diskutimi për kohën në familje, të cilat janë të përshtatshme për fëmijët, të rinjtë si dhe për të rriturit. Kjo ka një avantazh më shumë, sepse inkurajon tranzicionin e mësimit dhe rritjes frymërore nga një proces kryesisht i bazuar te kisha në një proces më të përqendruar tek familja.

MOTIVONI DASHURINË PËR PERËNDINË DHE PËR FJALËN E TIJ

Përgjegjësitë, zënia me punë dhe stresi komplotojnë së bashku për të na shteruar nga gjallëria jonë frymërore, si dhe për të na

penguar që të rritemi. Na duhet motivim i vazhdueshëm për të qenë ngulmues ndërsa e ndjekim Jezusin dhe bëhemi më shumë si Ai. Si motiv për bindjen e tyre, predikuesit mund t'i tërheqë në mënyrë të vlefshme detyra e krishterë. Megjithatë, vetëm kjo do të na çojë në bërjen e minimumit të kërkuar, dhe shpesh me shumë pak gëzim. Kini parasysh vëllain e madh tek shëmbëlltyra e djalit plëngprishës.

Përtej detyrës, mënyra si e shikojmë ne Perëndinë përcakton kapacitetin tonë për ta dashur Atë si dhe dëshirën tonë për t'i shërbyer dhe për t'u rritur në marrëdhënie me Të. Përmes predikimit, besimtarët duhet të shohin shenjtërinë, madhësitinë, bukurinë dhe dashurinë e Perëndisë, si dhe të çmojnë mirësinë, besnikërinë dhe faljen e Tij. Për dishepullizimin, është themelore që ta shohim Perëndinë si të mirë dhe të dashur, një Perëndi që është me ne dhe jo kundër nesh. Shkrimtari Riçard Fostër vërejtje me zgjuarsia se: "Jeta e krishterë nuk vjen duke shtrënguar dhëmbët, por duke rënë në dashuri".³

Për ne predikuesit, jetët tona duhet të jenë njësoj me fjalët tona. Nëse jetët tona karakterizohen nga një dashuri në rritje për Perëndinë dhe një endje për Të, atëherë do të rrezatojmë vërtetësi që i frymëzon të tjerët. Në të kundërt, përcjellja e fakteve rreth Perëndisë thjesht kthehet në një ushtrim për të kaluar informacion pa jetë frymërore. Anëtarët tanë e ndjejnë menjëherë nëse po flasim nga përvoja të freskëta frymërore apo kur flasim nga emocionet njerëzore. Si predikues, duhet t'i bëjmë rregullisht këtë pyetje vetes: "A po kultivojmë një dashuri personale për Perëndinë që të jetë e gjallë dhe e re në zemrat tona?".

Gjithashtu predikuesit duhet të ngulisin një vlerësim për Fjalën e Perëndisë, sepse dishepullizimi kërkon bindje ndaj saj. Një motivim i qëndrueshëm për ta ndjekur Fjalën e Perëndisë do të rezultojë atëherë kur dëgjuesit të shohin vlerën që ajo ka për lulëzimin e njeriut, në krahasim me mënyrën se si mëkati i zvogëlon, i dëmton dhe i shkatërron jetët tona.

Ngjitur me tharësen time të flokëve është një etiketë që më tregon se çfarë duhet

të bëj dhe të mos bëj me të:

1. Gjithmonë hiqeni nga priza pas përdorimit.
2. Mos e vendosni dhe mos e ruani në një vend ku tharësja mund të bjerë apo të tërhiqet në vaskë, në tualet apo në lavaman.
3. Mos e përdorni gjatë kohës që laheni në vaskë.
4. Mos e përdorni pranë ujit dhe mos e vendosni në ujë.
5. Nëse tharësja bie në ujë, hiqeni menjëherë nga priza; mos prekni ujin.

Po sikur unë të mendoj: “E pse më duhet ta lejoj prodhuesin që të më tregojë mua se si mund ta përdor tharësen time të flokëve? Në fund të fundit, unë kam paguar goxha para për të dhe tani më përket mua. Do ta përdor si të më dojë qejfi”. Me siguri që po tund kokën nga budallallëku im. Prodhuesi e vendos etiketën mbi tharësen e flokëve, jo thjesht se kështu e kërkon shteti, por sepse prodhuesi pranon rrezikun e një dëmtimi serioz ose të vdekjes nëse unë nuk e përdor ashtu siç duhet.

Besimtarët mund të acarohen nën ligjet e Perëndisë, për shkak se: 1) Është e vështirë t’u bindesh shumë prej atyre ligjeve. 2) Disa ligje sikur na i kufizojnë jetët. 3) Disa ligje shkojnë aq në kundërshtim me perceptimet dhe praktikën e shoqërisë, saqë ne vëmë në dyshim vlefshmërinë e tyre. 4) Disa ligje të tjera kërkojnë kurajë, rrezik dhe sakrificë. Për një motivim të gjatë karshi bindjes, besimtarët duhet të dallojnë *dëshirueshmërinë* e standardeve të Perëndisë. Kemi nevojë që ta shohim Perëndinë si dikush që na jep ligjet e Tij, sepse Ai e di që kjo është më e mira për ne.

Për vite me radhë i kujtoja rregullisht bashkësisë sime se ligjet e Perëndisë janë *përshkrime të realitetit*. Perëndia i tha Izraelit: “Të respektosh për të mirën tënde të gjitha urdhërimet dhe statutet e Zotit që sot të urdhëroj.” (Ligji i Përtërirë 10:13; Shih gjithashtu 4:40; 5:29, 33; 6:3, 24). Bindja ndaj ligjeve të Perëndisë na mbron dhe na aftëson që të përparojmë. Të shpërfillësh ligjet e Perëndisë do të thotë të shpërfillësh realitetin. Të jetuarit në një botë joreale, herët a vonë, do të rezultojë në jetesë të shtrembër, në lëndim të vetes dhe, eventualisht, në shkatërrim.

SFIDONI PERËNDITË E RREME DHE HEREZITË

Bota kërkon të na joshë me objektiva tërheqës dhe emergjentë, për ta larguar vëmendjen dhe energjinë tonë nga objektivat frymërorë. Shpesh, këto kthehen në perëndi të rreme në jetën tonë. Natyra e këtyre joshjeve nuk ka ndryshuar që prej kohëve biblike. Jezusi identifikoi tri kategori kryesore: “ua zënë frymën *shqetësimet*, *pasuritë* dhe *kënaqësitë* e jetës, dhe nuk arrijnë të piquen.” (Luka 8:14). Pasuritë dhe kënaqësitë e jetës janë të qarta. Shqetësimet jo vetëm që i referohen merakut rreth nevojave të

Grupet e vogla dhe disiplinat frymërore kanë fituar popullaritet si alternativat më të preferuara për rritje në dishepullizim, pjesërisht si rezultat i predikimeve të dobëta.

përditshme, por përfshijnë edhe objektivat, siç janë, siguria, aprovimi, suksesi, pushteti, ndikimi dhe përmbushja. Nëse Perëndia na bekon me këto, atëherë duhet t’i pranojmë me mirënjohje dhe t’i përdorim për qëllimet e Tij. Megjithatë, nëse vëmë si prioritet rendjen pas tyre, atëherë kjo do ta shterojë kohën dhe energjinë që na nevojitet për rritjen frymërore.

Predikuesit duhet të dallojnë se cilat joshje i tundojnë më së shumti dëgjuesit e tyre dhe të sfidojnë aftësinë e këtyre perëndive të rreme për të siguruar më shumë sesa përmbushje të pjesshme e të përkohshme. Ne duhet t’u ofrojmë besimtarëve një pamje të Perëndisë që siguron për atë që ne kemi vërtet nevojë, si dhe një pamje të vetes sonë si qenie të krijuara në imazhin e Perëndisë për të pasur marrëdhënie me Të. Të ndarë prej Tij, ne nuk mund të gjejmë kurrë kënaqësi të plotë e jetëgjatë.

Së bashku me joshjet, në çdo kulturë gjejmë me bollëk edhe *herezitë*. Shpeshherë të paperceptueshme, njësoj si raketat ndjekëse që fluturojnë ulët, herezitë rrëshqasin nën sistemet tona mbrojtëse dhe e dobësojnë besimin tonë duke ndryshuar gradualisht botëkuptimin tonë, pasionin tonë dhe vlerat tona. Konsideroni disa shembuj të herezive që po shumohen në shoqërinë tonë:

- Shqetësimi parësor në jetën tonë është që të kujdesemi për veten dhe për familjet tona.
- Perëndia ekziston që të kujdeset për nevojat tona atëherë kur burimet që kemi, janë të pamjaftueshme.
- Qëllimi përfundimtar në jetë është përmbushja personale.
- Arritjet, asetet dhe pamja e jashtme përcaktojnë vlerën tonë.
- Shumë prej mësimave biblike janë të vjetërsuara dhe nuk janë të përshtatshme për kohën tonë.
- Seksi është një shtysë e zakonshme të cilën beqarët, por edhe të martuarit, duhet ta kënaqin.

Herezitë, ashtu si barërat e këqij, vazhdojnë të mbijnë dhe të shumohen. Predikuesit duhet t’i vënë në dukje idetë e gabuara që qëndrojnë pas herezive aktuale kulturore, që ato të mos e dobësojnë përku-shtimin frymëror, jetën dhe rritjen e besimtarëve.

Duke i sfiduar ato, mund të zvogëlojmë ose minimizojmë ndikimin e tyre. Të harra hap vend për të rritur frytin frymëror.

MERRNI NGA FUQIA E HISTORIVE PERSONALE

Shpeshherë Jezusi përdori shembëlltyrat, që janë një formë tregimi. Tregimet janë me bollëk si në Dhjatën e Vjetër, ashtu edhe në të Renë. Predikuesit duhet të përdorin histori kur komunikojnë të vërtetën. Historitë ofrojnë përfitime të shumta, duke përfshirë edhe këto në vijim:

- Njerëzit mbajnë mend më lehtësisht historitë sesa deklaratat abstrakte të të vërtetës. Ndërkohë që njerëzit i ridëgjojnë historitë në mendjen e tyre, ata kujtohen rreth të vërtetave që iu kemi komunikuar, dhe këto të vërteta përforcohen edhe më tej në mendjet e tyre.
- Historitë i flasin zemrës dhe imagjinatës, por gjithashtu edhe mendjes. Në këtë mënyrë, historitë lënë përshtypje më të madhe dhe përshtypje që zgjat.

Historitë tona personale mund të kenë tek të tjerët një ndikim edhe më të fuqishëm sesa historitë e personave të tjerë. Atëherë kur është e përshtatshme, ne duhet të ndajmë edhe mundimet tona. Kjo prodhon një sërë ndikimesh. Së pari, njerëzit e vlerësojnë faktin që ne flasim nga përvoja dhe jo thjesht në teori. Së dyti, ata e identifikojnë

veten me ne, sepse edhe ata kanë dobësi. Së treti, cënueshmëria jonë i inkurajon ata që të shohin me ndershmëri jetët e tyre. Së katërti, duke u identifikuar me dështimet tona, ata gjithashtu gjejnë veten në sukseset tona. Ata marrin shpresë për mundimet e tyre: “Ai është njeri. Është munduar nga gjërat që po përjetoj edhe unë tani. Me ndihmën e Perëndisë, ai e kapërceu problemin e tij. Kjo më jep mua besim që edhe unë mund t’ia dal mbanë.”

FLISNI PËR TË GJITHA ASPEKTET E JETËS

Në tetor të vitit 2010 në Konferencën e Lozanës mbajtur në Kejpt Taun të Afrikës së Jugut, 4 mijë delegatë ungjillorë nga e gjitha bota rrëfyen publikisht mungesën që kishte Kisha për një dishepullizim gjithëpërfshirës: “Ne kemi dështuar që të paraqesim të gjitha aspektet e jetës nën sundimin e Krishtit”.⁴ Predikimi zakonisht fokusohet në jetën frymërore, e cila qëndron në thelb të jetës së krishterë. Aty dëgjojmë thirrjen për të dashur dhe për të adhuruar Perëndinë, për t’i besuar Atij, dhe për t’u bindur e për t’i shërbyer. Marrja e fuqizimit të Frymës na aftëson që të marrim pjesë në misionin e Tij në botë dhe na aftëson që të transformohemi në imazhin e Krishtit. E gjitha kjo është mirë. Megjithatë, edhe pse jeta frymërore ka prioritet, ne nuk mund t’i shpërfillim aspektet e tjera të jetës, të cilat duhet gjithashtu që të bien nën sundimin e Jezusit.

Predikimi për dishepullizim duhet të përfshijë



3 Mënyra për të Mbështetur Predikimin për Dishepullizim

Janë tri rrugë të cilat mund të kontribuojnë fuqishëm në procesin e dishepullizimit dhe formimit frymëror. E para, si diçka e praktikuar aktualisht, është shpesh e padobishme. E dyta dhe e treta kanë nevojë për shumë më tepër përdorim të shpeshtë.

GRUPET E VOGLA

Dhjata e Re ilustron nevojën për një komunitet të mirëfilltë frymëror për rritjen në dishepullizim. Për shkak se kishat gjithnjë e më shumë në rritje e kuptojnë se cilësia e kërkuar e marrëdhënieve ndodh kryesisht në grupet e vogla, këto të fundit janë shumë. Megjithatë, Barna doli në përfundimin se shumica e tyre *nuk janë efikase* në dishepullizim.¹ Një nga arsytet është se ato kryesisht fokusohen në mësimin e njohurive, gjë e cila mund të bëhet më mirë përmes mësuesve të kualifikuar. Ky theks i vendosur në vendin e gabuar zvogëlon kohën e disponueshme për katër vlerat kyçe të grupeve të vogla në promovimin e rritjes: pjesëmarrja aktive, tregimi i ngjarjeve nga jeta e vetë personit, vënia në zbatim për veten dhe llogaridhënia e ndërsjellë.

DISIPLINAT FRYMËRORE

Disiplinat frymërore përputhen me udhëzimin e Palit për Timoteun: “Ushtroni në perëndishmëri” (1 Timoteut 4:7). Disiplinat e tilla si: adhurimi, lutja, shërbesa dhe dëshmia janë qëllime frymërore në vetvete, si edhe mjete për rritje. Të tjerat, siç janë heshtja, vetmia, studimi, agjërimi, thjeshtësia dhe rrëfimi, na ndihmojnë të largojmë shpërqendrimet e jetës. Kjo i çliron mendjet dhe shpirtrat tanë për t’u fokusuar në përjetimin e pranisë së Perëndisë, si dhe për të marrë udhëzimin dhe udhëheqjen e Tij. Për rrjedhojë, Ai mund të na fuqizojë për të përbushur misionin tonë dhe për t’u bërë më shumë si Jezusi.

REAGIMI NDAJ RRETHANAVE TË JETËS

Edhe ndërsa i vlerësoj dhe i praktikoj mjetet tradicionale për t’u rritur, kam kuptuar se jam rritur po aq shumë edhe përmes rrethanave të paplanifikuara, dhe shpesh të padëshiruara, të jetës. Kur reagojmë siç duhet ndaj situatave që lindin në jetët tona, atëherë ato prodhojnë rritje frymërore. Në të kundërt, reagimet e papërshtatshme e pengojnë këtë rritje. Edhe pse Perëndia nuk është zakonisht iniciatori i këtyre rrethanave, Ai i përdor ato rregullisht për pjekjen tonë, ndërkohë që ne bashkëpunojmë me Të. Ato përfshijnë: vendimet e përditshme për t’u bindur, zgjedhjet e vështira të jetës, sprovat, fajet dhe ndjenjat negative. Bashkë me reagimet specifike, ne mund të besojmë në këto rrethana se Perëndia “bashkëvepron për të mirë” (Romakëve 8:28).

-- STEPHEN LIM

Shënim

1. George Barna, *Growing True Disciples [Rritja e Dishepujve të Vërtetë]* (Colorado Springs: Waterbrook Press, 2001), 92,94.

aspektet e jetës së përditshme, duke përfshirë kuptimin, qëndrimet dhe sjelljet tona që lidhen me punën, karrierën, suksesin, paratë, gjërat që zotërojmë, kohën e lirë dhe median. Gjithashtu duhet të predikojmë mbi marrëdhëniet, sidomos mbi aspektet e neglizhuara të dashurisë romantike dhe seksualitetit, të cilat shtrembërohen kaq keq nga kultura jonë, duke krijuar kështu shumë dhimbje dhe brengë.

Predikuesit duhet të merren gjithashtu me përgjegjësitë e besimtarit në botë. Kjo nuk përfshin vetëm ungjillëzimin dhe misionin, edhe pse këto gjëra kanë rëndësi të veçantë. Sipas Fjalës së Perëndisë, të krishterët duhet të angazhohen gjithashtu në nevojat praktike të njerëzve për mbështetje fizike dhe drejtësi.

MERRUNI ME PJEKJEN PERSONALE DHE ÇËSHTJET PERSONALE

Pjekja personale gërshetohet ngushtësisht me rritjen frymërore. Ne nuk mund të piqemi nga ana frymërore, pa u pjekur nga ana personale. Unë kam njohur besimtarë të cilët kanë pasur një zell të madh për Perëndinë, e megjithatë të japin përshtypjen se sjellin një ndryshim shumë të vogël frymëror tek jetët e të tjerëve. Pse? Dobësitë e tyre në marrëdhënie ose papjekuritë e tyre emocionale e neutralizojnë ose e kufizojnë efikasitetin e ndikimit, shërbesës dhe dëshmisë së tyre. Pjekja personale përfshin: vetëdije dhe rritje emocionale, kuptim të ndikimeve të kaluara dhe të tashme në jetët tona, shërim për plagët e brendshme, zhvillim mendor dhe moral, si dhe marrëdhënie dhe funksionim të shëndetshëm. Burimet frymërore mund të ndihmojnë procesin e pjekjes personale, e cila, nga ana tjetër, inkurajon rritje frymërore.

Shumica e predikuesve nuk e kanë shumë të njohur këtë fushë, duke qenë se literatura e dishepullizimit shumë rrallë e përmend atë dhe trajnimi i tyre për shërbesë zakonisht nuk e mbulon si temë. Prandaj duhet të kërkojmë që qëllimisht të rritemi në këtë fushë. Ne duhet të tregojmë në predikimin tonë që kemi pasur mundime dhe se si kemi mësuar t'i kapërcejmë çështjet personale negative me ndihmën e Frymës së Perëndisë.

Për shembull, edhe pse pasioni për shërbesë është diçka e mirë, mu deshën vite për të kuptuar që një pjesë e varësisë sime ndaj punës në shërbesë vinte nga një shtysë e pashëndetshme. Edhe pse kisha nevojë që të flija më shumë gjumë, arsyetoja që mund t'ia dilja mbanë edhe vetëm me gjashtë orë fjetje, gjë që më mundësonte të kaloja më shumë kohë në shërbesë. Unë besoja se ishte në dorën time që të përmbushja nevojat e kishës, ndërkohë që bëja gjithçka që ishte e mundur për t'ia komunikuar ungjillin një bote të humbur.

Për rrjedhojë, shpesh ndihesha i ngadaltë dhe i përgjumur gjatë ditës. Në retrospektivë, do të kisha arritur më shumë në qoftë se do të kisha pushuar siç duhet. Një ditë më zuri gjumi ndërsa po i jepja makinës dhe u përplasa me një pemë, duke e shkatërruar makinën. Por as kjo nuk e ndryshoi mënyrën time të sëmure të jetesës. Ndërkohë që motivet e mia të ndërgjegjshme dukeshin fisnike, shtysa ime vinte si rrjedhojë e vlerësimit të ulët të vetes. Unë orvatesha që të kisha sukses në shërbesë për t'i vërtetuar vetes që kisha vlerë si person. Fatmirësisht, përjetova (jo thjesht kuptova nga ana intelektuale) eventualisht realitetin se vlera ime nuk vjen nga ajo që unë arrij, por nga dashuria e Perëndisë për mua.

Disa çështje të tjera personale të cilat mund ta pengojnë rritjen frymërore, janë edhe këto: dhimbja emocionale e pazgjidhur, shmangia e së vërtetës për sa i përket dobësive tona, mungesa e vetëdijes për emocionet tona dhe për shkakun e tyre, perfeksionizmi, varësia ndaj partnerit si dhe ndjenja e pasjes së drejtë. Në qoftë se ndonjë prej këtyre çështjeve ndikon mbi jetët tona, ato e parandalojnë Jezusin që të jetë plotësisht Zot. Predikimi për dishepullizim mund t'i zbulojë këto çështje me ndjeshmëri, në mënyrë që besimtarët të mund të kërkojnë këshillim frymëror, mbështetjen e të tjerëve, si dhe fuqinë e Frymës për t'u përballur me këto pengesa të dishepullizimit.

Ndërkohë që i vini në zbatim këto gjashtë faktorë rreth predikimit për dishepullizim, kërkoni aftësimin e Frymës së Perëndisë për vete dhe për bashkësinë tuaj. Më pas, jo vetëm që bashkësia do t'i mbajë mend predikimet tuaja, por predikimi juaj realisht mund të ndryshojë jetë duke formuar dishepuj për Jezusin.

Shënime

1. *The Barna Update*, August 9, 2005. Shikuar më 02 Prill 2012.
2. Lori Carrell, "Sermons Most Likely to Succeed," në revistën *Rev!*, numri i muajve Maj / Qershor 2007, 71.
3. Richard Foster, *Streams of Living Water* (Harper San Francisco, 1998), 51.
4. *The Cape Town Commitment: Lausanne 2010*. Shikuar më 02 Prill. 2012.



STEPHEN LIM, D. Min., dekan dhe pedagog i udhëheqësisë dhe shërbesës në Seminarin Teologjik të Asambleve të Perëndisë, Springfield, Misuri.



BINDJE E MENJËHERSHME:

AVENTURA PËR T'U AKORDUAR
TE PERËNDIA

Nga: ROD LOY

ZBULONI ATË FUSHË TË JETËS SUAJ E CILA DO T'JU BËJË NJË NJERI MË TË MIRË DHE NJË UDHËHEQËS MË TË MIRË, DUKE PRANUAR SFIDËN NËNTËDHJETË-DITORE TË KËTIJ AUTORIT PËR TA TAKUAR PERËNDINË NË NJË MËNYRË MË TË PLOTË SE KURRË MË PARË.

Të zënë, të lodhur dhe konfuzë. Ky është një përshkrim i saktë për shumë njerëz në kulturën tonë, përfshirë këtu edhe shumë të krishterë. Ndërsa reagojmë ndaj kërkesave të jashtme me të cilat përballemi çdo ditë, e kemi të vështirë të mbajmë ritmin me prioritetet tona, dhe që të jem i sinqertë, shpesh zgjedhim gjërat e gabuara për t' i vendosur në krye të listave tona. Jemi jashtëzakonisht të zënë dhe çdo gjë duket se ka të njëjtën urgjencë. Në fund të ditës, jemi të rraskapitur, dhe prapë pyesim veten nëse arritëm ndonjë gjë domethënëse në fund të fundit.

Si të krishterë, ne duam të qëndrojmë përpara Jezusit një ditë dhe ta dëgjojmë teksa na thotë: "Të lumtë, shërbëtor i mirë dhe besnik; hyr në gëzimin e zotit tënd." (Mateu 25:21).

Por shumë prej nesh jetojmë me një dyshim të fshehur e gërnjar. Pyesim veten nëse zgjedhjet tona e kënaqin Atë dhe nuk jemi të sigurt nëse jetët tona po bëjnë ndryshimin.

Ekziston një mënyrë tjetër, një mënyrë më e mirë për të jetuar, një mënyrë më e mirë për t'u lidhur me Perëndinë dhe një mënyrë më e mirë për të qenë të sigurt se jetët tona kanë rëndësi. Dhe kjo mënyrë është duke u përkushtuar për t'iu bindur Perëndisë menjëherë, pavarësisht nga ajo që na thotë Zoti që të bëjmë.

Kur përgjigjemi me besim aktiv menjëherë pasi ia kemi dëgjuar zërin, atëherë gjithçka ndryshon! Ne akordohemi më shumë me zemrën e Perëndisë dhe bëhemi më të ndjeshëm ndaj njerëzve përqark nesh, si dhe fitojmë një vend në rreshtin e parë për të parë Perëndinë teksa bën gjëra të jashtëzakonshme brenda nesh dhe përmes nesh. Përfitojmë jetën me bollëk që Krishti ua premtoi atyre që e ndjekin me të vërtetë Atë.

Kur mësojmë ta kapim çdo çast, atëherë jetojmë me ndjenjën e mrekullisë shpresuese, e cila qëndron në pritje. Çdo moment (pavarësisht se sa i zakonshëm) mund të jetë një "moment me Perëndinë", dhe çdo takim (në rrugë, në shtëpi, në punë, etj.) me dikë (pavarësisht se sa i mërziqshëm mund të jetë ai) mund të jetë një "takim hyjnor". Prioriteti ynë zhvendoset nga kryerja e planeve tona egoiste ditore në përmbushjen e planit ditor të mbretërisë së Perëndisë.

NJË VIT, NJË JETË

Ata që më njohin, thonë për mua se jam një njeri goxha i disiplinuar dhe i detajuar. Mendoj se ky që jam është produkt edhe i gjenetikës, edhe i trajnimit. Im atë ishte një ekspert dhe programues kompjuterik që punonte për IBM-në. Unë kam gjenet e tij dhe gjithashtu e kam parë se si ai i menaxhonte qëllimet dhe problemet.

Para shumë kohësh zhvillova një zakon për të vendosur objektiva në gjashtë fusha të ndryshme të jetës sime në fillim të çdo viti, dhe jo vetëm një objektiv, por disa të tilla për secilën prej këtyre gjashtë fushave. Më pas krijova një plan të detajuar për t'i futur të gjitha brenda planit tim ditor.



Megjithatë, andej nga muaj i tretë ose i katërt i çdo viti, sasia dhe kompleksiteti i gjithë atyre objektivave rezultoi se ishte diçka e papërballueshme, madje, edhe për dikë që e ka në natyrën e vet të qenit i disiplinuar dhe i fokusuar. Pas shumë vitesh acarimi, vendosa t'i ngushtoja objektivat për vitin tjetër dhe të mbaja vetëm një për secilën nga gjashtë fushat. Por edhe kjo rezultoi e tepërt, kështu që e shkurtova fokusin tim dhe ngela me një objektiv, i cili do të ishte fokusi im për të gjithë vitin.

Përkushtimi për ta dëgjuar dhe për t'iu bindur menjëherë Atij e ka revolucionarizuar mënyrën se si e shoh secilën ditë.

Pyeta veten: "Cila është ajo fushë në jetën time, që nëse rritem dhe ndryshoj, do të më bëjë një njeri më të mirë dhe një udhëheqës më të mirë?"

Për ta ngushtuar gamën e alternativave (që gjithmonë janë shumë), unë përdora tri filtra: lutjen, të qenit i vetëdijshëm dhe mendimin e atyre që më njohin mirë. I kërkova Perëndisë që të vendoste një gjë në zemrën time. Unë e dija se Ai mund të më tregonte një mijë e një gjëra në jetën time që kishin nevojë për t'u përmirësuar, por unë i kërkova Atij që të synonte vetëm tek një gjë për atë vit. Ia kisha besën Atij se do të më jepte një pasqyrë të madhe e të qartë të së vërtetës në mënyrë që të mund të shihja se cilat gjëra i bëj mirë dhe cilat fusha kanë nevojë për t'u përmirësuar.

Qeniet njerëzore kanë një kapacitet pothuajse të pakufishëm për të gënjyer veten, kështu që unë nuk e marr me shaka analizimin e vetes. Ndërsa u luta dhe mendova, i kërkova bashkëshortes sime dhe disa miqve të mirë që të më jepnin një mendim në lidhje me gjërat që ata shihnin në jetën time. Zgjedha njerëz të cilët janë perceptues, që kishin interesin më të mirë në zemër, dhe më e rëndësishmja, kishin guximin të më thoshin të vërtetën.

Kur po kaloja përmes këtij procesi para disa vitesh, Perëndia më vendosi në zemër që të

përqendroheshja tek “falja e shpejtë”. Unë nuk i tregova kishës sonë rreth këtij procesi, dhe as nuk bëra ndonjë fushatë për t’ua mësuar të tjerëve. Por kuptova që në qoftë se nuk ngulitet së pari thellë në përvojën time personale, nuk kisha sesi t’u thosha të tjerëve që ta bënin atë. Për gati një vit, pyesja veten: “A i fal unë të tjerët, ashtu siç më fal Perëndia?”

Tek lutja e Zotit, “Ati Ynë”, Jezusi na mësoi që të lutemi, duke thënë: “Na i fal fajet tona, siç ua falim edhe ne fajtorëve tanë.” (Mateu 6:12).

Kjo nuk do të thotë që falja e Perëndisë është e kushtëzuar, në bazë të gatishmërisë sonë për të falur. Në fakt është e kundërta. Gatishmëria jonë dhe kapaciteti ynë për të falur ata të cilët na lëndojnë, është një tepriçë e përvojës që ne kemi për faljen absolute, të plotë dhe të menjëhershme të Krishtit për mëkatet tona. Pali e vazhdon këtë lidhje në dy nga letrat e tij, ndërsa i shpjegon kishës: “Jini të mirë dhe të përdëlltyshëm njëri me tjetrin, duke e falur njëri-tjetrin, sikurse edhe Perëndia ju ka falur në Krishtin.” (Efesianëve 4:32, krah. Kolosianëve 3:13).

Gjatë atij viti, çdo ditë i kërkoja Perëndisë që ta depërtonte fuqinë dhe bukurinë e faljes edhe më thellë brenda zemrës sime, derisa të tepronte dhe të

derdhej në marrëdhëniet e mia. Sigurisht, kur përpiqemi të falim dikë që na ka lënduar apo tradhtuar, përjetojmë pengesën e natyrshme të zemërimit. Ndërsa lutesha, Perëndia më kujtoi disa persona të cilët unë i kisha justifikuar dhe isha përpjekur t’i harroja, por nuk i kisha falur në të vërtetë. Ishte një vit pastrimi i mrekullueshëm që më nxiti të shkoja më thellë në zemrën e Perëndisë dhe të ungjillit të hirit. Kur viti mbaroi, unë isha gati, më në fund, që t’i ndaja përvojat e mia me të tjerët.

Një vit tjetër, Perëndia më vuri në zemër që të fokusohesha tek bindja e menjëhershme. Në fillim, nuk isha i sigurt se çfarë do të thoshte kjo. A nuk po i bindesha unë tashmë Perëndisë? Unë mendoja se reagimet e mia ndaj pëshpëritjeve, prekjeve, mbresave dhe bërtitjeve të Perëndisë ishte një pikë e fortë e imja në ecjen me Të. Megjithatë, ndërsa lutesha dhe lexoja Shkrimin, Zoti më tregoi disa hendeqe, të mëdha madje, në reagimet e mia karshi Atij. Unë po reagoja, por disa herë me ngadalë apo madje edhe me hezitim. Kështu që çdo mëngjes ndërsa thosha përmendësh vargun: “Ardhtë mbretëria jote. U bëftë vullneti yt në tokë si në qiell”, bëja edhe këtë lutje shtesë: “O Perëndi, le ta dëgjoj zërin Tënd dhe ta ndjej udhëheqjen Tënde në mënyrë që të të bindem menjëherë.”

Unë nuk dëshiroja të humbisja ndonjë “çast me Perëndinë” për shkak të shurdhësisë frymërore apo përgjigjeve a reagimeve të vonuara. I kërkoja Perëndisë që të pastronte veshët e mi frymërorë, të më jepte një zemër pranuese dhe të ndjeshme dhe të më siguronte kurajën për t’u hedhur menjëherë në veprim për çfarëdo që Ai të më thoshte të bëja.

Ky ishte viti i bindjes së menjëhershme. Vepra ime e parë e bindjes ishte që të pranoja direktivën e Perëndisë për ta bërë këtë përkushtim për gjithë vitin. Ai kishte folur, dhe tani ishte në dorën time që të bindesha menjëherë. Nuk e kisha idenë se ku po më çonte e gjithë kjo, por pranova t’i bashkohesha. Ndjeja shumë pasiguri, dhe për të qenë i singertë, edhe shumë frikë. Ndjehesha gjithashtu edhe pak konfuz. Në fund të fundit, isha pastor i një kisha. Nuk duhet të ndihesha i kërcënuar nga ftesa e Perëndisë për të dëgjuar zërin e Tij dhe për t’u përgjigjur me besim, por kuptova menjëherë se ky përkushtim hapi dyer të reja drejt përvojës frymërore. Çfarë do të më kërkojë vallë që të bëj? A do të jem në siklet kur t’i bindem Atij? A do dukem i çuditshëm? A do jem i çuditshëm?

Çdo mëngjes, për një vit, i kërkoja Perëndisë që të më bënte të ndjeshëm ndaj zërit të Tij në mënyrë që të merrja masa dhe ta bëja mbretërinë e Tij të vinte më me plotësi tek njerëzit që takoja çdo ditë. Më

6 GJASHTË HAPA DREJT BINDJES SË MENJËHERSHME

1 Lutja: “O Perëndi, do të bëj atë që Ti më thua që të bëj, do të jap atë që Ti më thua që të jap dhe do të shkoj aty ku Ti më thua që të shkoj. Madje, që përpara se të ma kërkosha, përgjigja ime është: ‘Po, Zot!’ Po të dëgjoj, o Zot...”

2 Lexoni fragmentin e përditshëm. Çfarë po ju thotë Perëndia përmes këtij fragmenti nga Shkrimi?

3 A po ju thotë Perëndia që t’i bindeni Atij sot në një mënyrë specifike? Në qoftë se përgjigja është: “Po”, në çfarë mënyrë?

4 Nga dje (ose nga java e kaluar), çfarë keni dëgjuar nga Perëndia që duhet të bëni? Si reaguat? Si u ndjetë mbasi reaguat?

5 A keni përjetuar ndonjë qëndresë apo keqkuptim të udhëzimeve të Perëndisë gjatë 24 orëve të fundit? Në qoftë se përgjigja është: “Po”, përshkruajeni.

6 Lutuni: Kërkojini Perëndisë përlësi për ta dëgjuar Atë dhe kurajë për ta ndjekur Atë sot.

— ROD LOY, North Little Rock, Arkansas

erdhi ndërmend një këngë e vjetër që thotë:

**"I dashur Zot, do të shkoj atje ku ti
do që të shkoj,
Mbi male, dete e fusha me pem';
I dashur Zot, do të them atë që ti do
që të them;
Do të jem ai që ti do që të jem."**¹

QËNDRIMI I JEZUSIT

Gjatë gjithë vitit, Perëndia vazhdoi të më sillte ndërmend një fragment nga Letra e Palit Drejtuar Filipianëve. Ai shkroi: "Mos bëni asgjë për rivalitet, as për lavdi të kotë, por me përlulësi, secili ta çmojë tjetrin më shumë se vetveten. Të mos shikojë secili interesin e vet, por edhe atë të tjerëve. Kini në veten tuaj po atë mendje që ishte edhe në Jezu Krishtin." (Filipianëve 2:3-5).

Kini po atë mendje (qëndrim) si Krishti. Por për çfarë është duke folur Pali këtu? A është e mundur kjo? Apostulli nuk na lë të hamendësojmë. Ai thotë se qëndrimi i Krishtit ishte nënshtrimi i plotë ndaj vullnetit të Atit: "[Ai] e përluli veten duke u bërë i bindur deri në vdekje, edhe deri në vdekje të kryqit." (Filipianëve 2:8)

Oswald Chambers, në devocionin e tij klasik: "My Utmost for His Highest", na inkurajon që ta dëgjojmë Perëndinë pavarësisht se çfarë na thotë Ai:

"Bëjeni zakon që të thoni: 'Fol, o Zot', dhe jeta do të kthehet në një romancë. Kurdoherë kur rrethanat ju shtrëngojnë, thoni: 'Fol, o Zot', dhe gjeni kohë për të dëgjuar. Ndëshkimi nuk është vetëm një mjet disipline, por qëllimi i tij është që të më çojë në pikën ku them: 'Fol, o Zot'. Mendoni për një kohë në jetën tuaj kur Perëndia ju ka folur. A e mbani mend se çfarë ju tha? Ndërsa dëgjojmë, veshët tanë bëhen edhe më të ndjeshëm, dhe ashtu si Jezusi, edhe ne do ta dëgjojmë gjithmonë Perëndinë."²

Një mëngjes, ndërsa po mendoja dhe po lutesha duke pasur parasysh fragmentin nga Letra Drejtuar Filipianëve, kuptova që nuk isha ende në atë pikë. Dola në përfundimin se isha në njëfarë mase i bindur ndaj Perëndisë. Në qoftë se dikush do të më vinte armën në kokë dhe do të më kërcënonte se do të më vriste nëse do të thosha se isha ndjekës i Krishtit, besoj se do ta kisha kurajën për të shpallur se e njihja Atë. Por kjo ishte ndryshe. Perëndia po më kërkonte që të isha aq i bindur, sa që të isha i gatshëm të hiqja dorë nga planet e mia ditore, oraret dhe dëshirat e mia, dhe jo vetëm njëherë, por gjithë ditën, çdo ditë.

Plot njerëz thonë se janë të gatshëm të vdesin për Krishtin, por në qoftë se nuk jetoni një jetë në bindje, nuk ka shumë mundësi që të kenë një vdekje në bindje. Një jetë në bindje duhet të reflektohet, siç vuri në dukje edhe Pali, me përlulësi, mirësi dhe zemërgjerësi. Pyetja ime u bë: Në çdo çast të çfarëdo dite, çfarë duhet të vdesë brenda meje në mënyrë që Krishti të lartësohet? A jam i gatshëm që të jem i bindur në mënyrë aq radikale ndaj Perëndisë?

Kuptova se duhet të kthehesha tek fillimi dhe të gjeja një përkufizim funksionues të bindjes. Nuk mund të bindesha nëse nuk e dija se çfarë donte Perëndia që unë të bëja, prandaj, përbërësi i parë i domosdoshëm i bindjes është të dëgjojmë zërin e Tij. Perëndia përdor gjithfarë mënyrash për t'iu komunikuar njerëzve praninë e Tij dhe vullnetin e Tij: një shkurre në flakë, një kolonë resh dhe një kolonë zjarri, një pëshpëritje pas një tërmeti, një gomar, një shkrim me gisht në mur, shfaqjet e engjëjve dhe zëra nga qielli, për të përmendur vetëm disa prej tyre. Por mënyra me të cilën Perëndia ka zgjedhur që të flasë më qartë dhe më shpesh është përmes Shkrimit.

Në qoftë se i zhydim mendjet dhe zemrat tona në Fjalën e Perëndisë, mund të jemi të sigurt se Ai do ta ndriçojë të vërtetën e Tij mbi ne dhe do të na e shfaqë Vetën pikërisht aty. Detyra jonë, prej andej, bëhet reagimi me qëndrimin e Jezusit dhe bindja, e menjëhershme, e plotë dhe e guximshme, deri në vdekje.

PO SIKUR?

Ndërkohë që Perëndia më udhëhoqi që të bëja një përkushtim për t'u fokusuar për një vit mbi bindjen e



menjëhershme, unë pyesja veten: “Po sikur Perëndia të ketë diçka për mua që është shumë herë më e madhe nga sa mund ta imagjinoj unë?”. Unë nuk po mendoja për poste apo pushtet apo pasuri. Po merrja në konsideratë aventurën e të ecurit krah për krah me Mbretin sovran, të fuqishëm e të butë mbi të gjithë. A mund të kishte ndonjë aventurë më emocionuese (dhe kërcënuese) se kjo? Po sikur Perëndia të kishte detyra specifike për mua gjatë rrjedhës së ditës sime të zakonshme? Po sikur të isha mjaftueshëm i ndjeshëm sa të dëgjoja pëshpëritjet e Tij, dhe po sikur të isha mjaftueshëm i guximshëm sa të veproja kur t’ia dëgjoja zërin? A ishte e mundur që të mund të përfetoja hyjnoren në të zakonshmen?

Përgjatë rrjedhës së vitit, dhe çdo ditë që atëherë, e kam takuar Perëndinë më plotësisht se kurrë më parë. Përkushtimi për ta dëgjuar dhe për t’iu bindur menjëherë Atij e ka revolucionarizuar mënyrën se si e shoh secilën ditë. Lista ime e gjërave për të bërë nuk është më e zakonshme; është e mbushur me mundësinë që Perëndia mund të bëjë diçka spektakolare dhe të papritur në qoftë se ndjej direktivën e Tij në çdo çast. Takimet që unë bëj me njerëzit, qofshin këto të organizuara apo të rastësishme, gjithmonë mbartin mundësinë që Perëndia mund të futet në të zakonshmen dhe të më thotë të bëj diçka që ndryshon një jetë.

Këto hasje hyjnore mund të zgjasin vetëm për disa sekonda ose disa minuta, prandaj është thelbësore që unë të përgjigjem menjëherë kur dëgjoj zërin e Perëndisë. Patjetër, unë i humbas disa nga ato “çastet me Perëndinë”, ose sepse jam konfuz në lidhje me atë që ndjej nga Perëndia ose sepse jam shumë i ngadaltë në reagim. Por po bëj shumë praktikë! Me secilin reagim të guximshëm, unë bëhem edhe pak më shumë perceptues për ta dëgjuar atë, dhe bëhem edhe pak më shumë i sigurt se ia vlen që të kesh qëndrimin e Krishtit në çdo moment të çdo dite.

Perëndia nuk duhet të më tregojë se çfarë plani ka Ai para se të marr unë ndonjë masë, dhe as unë nuk duhet të shoh rezultate të qarta pasi të bindem. Perëndia thjesht më kërkon të bëj atë që Ai më udhëzon dhe që t’ia lë atij rezultatet. Këtë bëri edhe Jezusi. Kudo ku Ai shkoi, Ai bëri pikërisht atë që Ati i kërkonte të bënte. Por rezultatet, për të thënë më të paktën, ishin të përziera: Disa e adhuruan, disa e kishin frikë, dhe disa e përçmonin. Kur unë dëgjoj zërin e Perëndisë dhe kur bindem për të hyrë në jetët e njerëzve, mund të pres që disa të jenë mirënjohës, disa të jenë konfuzë dhe disa të mendojnë se më ka ikur mendja. Unë s’e kam problem.

HAPI I PARË

Pas “vitit tim të bindjes së menjëhershme”, për t’i kuptuar vetë së pari parimet dhe për t’i vënë ato në zbatim, ia dhashë si mësim këto parime edhe kishës sonë. Reagimi ka qenë më emocionues nga sa mund ta imagjinoja unë. Jam tejet i gëzuar për atë që Perëndia ka qenë duke bërë te njerëzit dhe përmes njerëzve tanë, ndërsa veshët e tyre frymërorë janë hapur dhe ata iu përgjigjen menjëherë direktivave të Perëndisë.

Në librin tim, unë nxjerr një sfidë nëntëdhjetë-ditore si një eksperiment. Për tre muaj lexoni Shkrimin, lutuni dhe prisni që Perëndia t’ju udhëheqë. Ashtu si çdo aftësi apo zakon i ri, edhe bindja ka një kurbë mësimi. Ndërkohë që e praktikoni bindjen e menjëhershme, disa gjëra do t’i bëni siç duhet, ndërsa disa herë nuk do të gjuani në shenjë. Unë jam ende duke mësuar, dhe pres që të vazhdoj të mësoj për gjithë jetën time.

Megjithatë, rrugëtimi juaj nuk është përcaktuar që të mbarojë pas nëntëdhjetë ditëve. Unë shpresoj që dëgjimin dhe bindjen ta bëni prioritet thelbësor të jetës suaj. Nuk ka asnjë garanci që Perëndia do të flasë në një kohë të caktuar rreth një personi apo situatë të caktuar. Ne thjesht hapim zemrat tona ndaj faktit që Perëndia mezi pret që të na komunikojë zemrën dhe qëllimet e Tij. Në qoftë se e dëgjojmë dhe i bindemi Atij, një botë plot me mundësi shpaloset përpara nesh.

Njerëzit që praktikojnë bindjen e menjëhershme janë ata me të cilët duam të rrimë e të kalojmë kohë. Dëgjojmë historitë e tyre dhe mrekullohemi nga mënyra se si i përdor Perëndia ata. Edhe ju mund të jeni si njëri prej këtyre. Provojeni njëherë, dhe shikoni se ç’ndodh. Nuk keni asgjë për të humbur – dhe keni gjithçka për të fituar.

Ky artikull është përshtatur nga libri Immediate Obedience: The Adventure of Tuning in to God (Influence Resources: Springfield, 2014).

Shënime


1. “I’ll Go Where You Want Me to Go,” teksti nga Mary Brown, 1856–1918, muzika nga Carrie E. Rounsefell, 1894.
2. Oswald Chambers, *My Utmost for His Highest* (Discovery House Publishers: Grand Rapids, 2006).



ROD LOY, pastor kryesor në Asamblenë e Parë të Perëndisë në North Litell Rok, Arkansas, dhe plak vendim-marrës kishe për Këshillin e Përgjithshëm të Asambleve të Perëndisë, Springfield, Misuri.

TAKIME HYJNORE

Nga: **MARCIA LEDNICKY**





shte një ditë e bukur. Thjesht një ditë e zakonshme. Hymë brenda zyrave ku ishte caktuar që të mbahej një takim dhe na shoqëruan tek një dhomë private për t'u takuar me një grua të cilën nuk e kishim njohur kurrë më parë. Filloi një marrëdhënie. Prej asaj dite, kam pasur disa raste të tjera për t'u takuar me këtë grua për çështje pune. Gjithmonë kërkonim për të duke përdorur emrin e saj. Në një nga ato rastet kur takoheshim, i dhamë një libër, të cilin e kishte shkruar bashkëshorti im. Bisedat tona gjithmonë përfshinin momente kur ne flisnim rreth udhëtimeve që kishim bërë nëpër

botë, si edhe qëllimin e atyre udhëtimeve, i cili, sigurisht, ishte që t'u tregonim të tjerëve rreth Jezusit. Herët e shumta që kishim përjetuar mbrojtje hyjnore hapën para nesh dyer të tjera për të folur rreth afërsisë personale të Zotit tonë.



Herë pas here, do të sillja diçka me vete, nga një prej udhëtimeve tona, për t'ia dhënë asaj si dhuratë. Me fjalë të tjera, çdo rast që ne ishim bashkë ishte një "takim" i veçantë për t'i treguar që kujdeseshim dhe interesoheshim me të vërtetë për të si njeri, dhe jo thjesht si një e njohur pune. Në çdo situatë, qoftë me miq të vjetër prej vitesh apo me të njohur të rinj, është gjithmonë e rëndësishme që të kërkojmë të jemi një përfaqësuese e mirë e Jezusit si ndjekëse e Tij. Çfarë privilegji kemi që të shpalojmë dashurinë dhe hirin e Tij!

Më lejoni të bëj një kapërcim të shpejtë prej atij takimi të parë para shumë vjetësh tek para disa ditësh. Sapo ishim kthyer nga një udhëtim rreth gjashtë-javor jashtë shtetit, dhe, patjetër, mbërritëm në shtëpi jashtëzakonisht të lodhur dhe të rraskapitur nga ndryshimi i brezave orare. Ditën e dytë pasi kishim mbërritur në shtëpi, ndjeva një shtytje në zemrën time për ta marrë këtë grua në telefon. Dua të kuptoni se ajo nuk ishte pjesë e familjes, dhe as pjesë e familjes së kishës. Unë e mora në telefon thjesht për ta pyetur si ishte. Brenda disa minutave ajo më tregoi se kompania për të cilën punonte, ishte shitur dhe i gjithë stafi që punonte në zyrë kishte humbur punën. I shpreha keqardhjen time të singërtë. Pasi kontrollova oraret me bashkëshortin tim, e mora përsëri në telefon për ta pyetur nëse ishte e lirë për drekë ditën tjetër. Edhe pse jetojmë rreth 70 kilometra nga qyteti i saj, ditën tjetër, të lodhur, të rraskapitur, edhe pse duhet të bëja shumë gjëra në shtëpi, e morëm rrugën dhe dolëm për drekë me të. Kjo ishte ajo që Fryma më kishte folur në zemër për të bërë. Nuk kishin kaluar as 5 minuta që kur u ulëm për drekë dhe ajo, shumë e tronditur, filloi të tregonte historinë e saj. Sapo kishte humbur punën. Para tre ditëve bashkëshorti i kishte thënë se donte të divorcohej. Na zbuloi faktin se bashkëshorti i saj ishte i alkoolizuar, ndërsa ajo po kurohej pikërisht nga alkooli. Përveç një vajze 16 vjeç, nuk kishte asnjë të afërm tjetër. Një pjesë të mirë të pasdites e kaluam vetëm duke dëgjuar, duke treguar dashuri dhe keqardhje dhe duke u lutur me të. Që prej asaj dite kemi qenë shumë herë në kontakt me të për ta siguruar atë rreth dashurisë dhe kujdesit të Perëndisë edhe në këto situata të vështira.

Ajo që para disa muajsh nisi si një ditë e zakonshme, duke u takuar me një biznesmene të cilën nuk e kishim takuar më parë, u kthye në një mundësi të jashtëzakonshme për ta udhëhequr dhe inkurajuar këtë grua të pikëlluar që të ndiqte me gjithë zemër Jezusin. E kemi siguruar shpesh që po e mbajmë emrin e saj në lutje çdo ditë. Lutja jonë e zjarrtë për të është që Perëndia do ta shfaqë personalisht Vetën tek ajo. Zemrat tona duhet të jenë të ndjeshme ndaj udhëheqjes së Tij. Kur sapo u kthyem nga një tjetër udhëtim i gjatë jashtë shtetit, morëm një letër prej saj ku na pyeste nëse ishim kthyer në SHBA. Nga një grua së cilës i ishte mohuar dashuria dhe ishte ndjerë shumë e vetmuar, ajo tashmë shprehu dashurinë e saj për ne. Meqë ra fjala, ne do takohemi përsëri me të vetëm pas disa ditësh. Perëndia pa një grua të dëshpëruar që kishte nevojë për dhembshurinë dhe dashurinë e Tij dhe na dërgoi neve që të ndanim shpresën që gjendet tek mesazhi i ungjillit. Çfarë gëzimi dhe privilegji është që të dimë se i Plotfuqishmi po punon përmes nesh.

Mendoni pak për këtë. Me kë do t'ju vendosë në kontakt Perëndia sot ndërsa vazhdoni rrjedhën normale të jetës suaj? Në qoftë se jeni të hapura ndaj veprave të Frymës, me shumë mundësi që një ditë do të kuptoni se ishte një "takim hyjnor". Shpeshherë, lëndimet dhe sfidat e njerëzve që takojmë edhe rastësisht edhe për punë, janë të fshehura thellë brenda tyre. Por ne njohim një Shpëtimtar të dashur, i cili kujdeset për çdo person dhe nuk është i gatshëm që ndonjë të humbasë.

TAKIME TË PAPLANIFIKUARA

Shkrimi na thotë se ndërkohë që Jezusi ishte në tokë, Ai pati pikërisht këto lloje takimesh. Në kapitullin e 8 të Gjonit (vargjet 3-11), apostulli flet rreth gruas që u kap duke bërë tradhti bashkëshortore dhe u soll tek Jezusi nga udhëheqësit fetarë izraelitë. Këta burra donin ta vrisnin me gurë. Jezusi i vështroi ata dhe

tha: "*Kush nga ju është pa mëkat, le ta hedhë i pari gurin mbi të.*" (Gjoni 8:7). Një nga një, ata filluan të largoheshin. Ai vështroi gruan dhe e pyeti: "*O grua, ku janë paditësit e tu?*" Ajo u përgjigj se nuk kishte asnjë, dhe Jezusi iu përgjigj: "*As unë nuk të dënoj; shko dhe mos mëkato më*" (Gjoni 8:11). Në këtë fragment gjenden dy mësimet të rëndësishme: (1) Jezusi fali mëkatin e saj, dhe (2) Ai gjithashtu e qortoi atë duke i thënë të shkonte e të mos mëkatonte më. Ky ishte një takim i paplanifikuar; megjithatë, ishte një "takim hyjnor". A është e njëjta gjë e vërtetë edhe për ne sot? Sigurisht! Mund të ndodhë në treg ose ndërsa jeni duke pritur, bashkë me nënat e tjera, për fëmijën që t'ju kthehet në shtëpi nga shkolla. Po, madje mund të ndodhë edhe në kishë, kur dikush që është thyer vjen në kërkim të një vendi ku ka falje dhe paqe.

TAKIME TË QËLLIMSHME

Në një tjetër fragment nga Ungjilli sipas Gjonit, te kapitulli 4, shohim një takim që duket se është shumë i qëllimshëm. Jezusi po kthehej nga Judea (në jug) për të shkuar përsëri në Galile (në veri). Ai zgjodhi që të kalonte përmes Samarisë (Gjoni 4:4), edhe pse hebrenjtë dhe samaritanët (të cilët ishin të përzier në prejardhjen e tyre, pak hebrenj e pak johebrenj) kishin një marrëdhënie shumë armiqësore mes tyre. Zakonisht hebrenjtë përshkruanin një distancë më të gjatë që të shmangin kalimin përmes Samarisë. Por, Ai ishte i përkushtuar për t'i sjellë njerëzit e të gjitha sfondeve, racave, kulturave në një marrëdhënie personale me Atin e Tij qiellor. Historia e mirënjohur e gruas samaritane te pusi (Gjoni 4:4-42) ofron shumë udhëzime për të ndarë mesazhin e Krishtit. (1) Jezusi e filloi me diçka që "nuk ishte kërcënuese" – Ai thjesht kërkoi një gllënjë ujë. (2) Ai nuk debatoi me të për çështje fetare. Jezusi qëndroi i fokusuar te drejtimi për nga Ati qiellor. (3) Ai adresoi situatën mëkatore në jetën e saj. E megjithatë, qasja

Shpeshherë, lëndimet dhe sfidat e njerëzve që takojmë janë të fshehura thellë brenda tyre. Por ne njohim një Shpëtimtar të dashur, i cili kujdeset për çdo person dhe nuk është i gatshëm që ndonjë të humbasë.

e Tij ishte plot dhembshuri. Aq shumë, saqë kjo grua deklaroi menjëherë se Krishti ishte një profet. Është shumë e qartë se në atë çast ajo u ndryshua. Ajo u kthye me vrap në fshat dhe u bë një “ungjilltare” duke i inkurajuar të gjithë banorët e fshatit që të vinin e ta dëgjonin këtë burrë.

Si ndjekëse të Tij, bëni një përpjekje të qëllimshme për t'i arritur të gjithë njerëzit dhe për të ndarë “ujin e gjallë që ata të mos kishin më etje përsëri” (Gjoni 4:13). Nuk është e thënë që takimet hyjnore të jenë të papritura apo të paplanifikuara. Vendoseni qëllimisht veten në ato situata ku ju mund të jeni një dëshmi, edhe me jetën tuaj, edhe me fjalët tuaja të vajosura.

TAKIME TË INICIUARA NGA FRYMA E SHENJTË

Ekzistojnë ato raste të veçanta kur Fryma e Shenjtë na flet specifikisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë. I këtillë ishte rasti për të cilin lexojmë tek Veprat e Apostujve, kapitulli 8. Filipi, një nga dhjakët e parë, ndodhej në një rizgjim të madh në të gjithë qytetin e Samarisë (Veprat e Apostujve 8:5-25). Megjithatë, edhe kur bëhej një vizitë e veçantë nga Fryma, Shkrimi na thotë se Filipi udhëhoq në mënyrë hyjnore nga Fryma për të shkuar: “Ngrihu dhe shko drejt jugut, në rrugën që nga Jerusalemi zbrit në Gaza; ajo është e shkretë. Ai u ngrit dhe u nis; dhe ja, një burrë Etiopas, eunuk, një zyrtar i lartë i Kandaces, mbretëreshës së Etiopisë, përgjegjës i të gjitha thesareve të saj” (Veprat e Apostujve 8:26, 27). Ishte një zyrtar i lartë që kishte shkuar në Jerusalem për të adhuruar. Rrugës për në shtëpi, ai ishte ulur në karrocën e tij dhe po lexonte librin e Isaias nga Dhjata e Vjetër. Fryma i tha Filipit: “Afrohu dhe ngjitju asaj karroce”. Filipi e pyeti burrin nëse po e kuptonte

atë që po lexonte, dhe burri iu përgjigj: “E si do të mundja, po s’pata një që të më udhëzojë? Të lutem, për këtë thotë profeti këtë? Për veten apo për ndonjë tjetër?” (Veprat e Apostujve 8:29-35). Atëherë Filipi e filloi pikërisht me atë varg dhe i tregoi zyrtarit lajmin e mirë rreth Jezusit. Mendoni pak për ndikimin që ky burrë kishte në Etiopi. Mund të duket paksa e çuditshme që Fryma e drejtoi Filipin të largohej nga një rizgjim madhështor; megjithatë, ky burrë do ta çonte ungjillin në një komb tjetër. Perëndia dëshiron që të gjithë ta njohin Birin e Tij dhe gëzimin e shpëtimit!

Do të ketë raste kur do e dini pa më të voglin dyshim se jeni të drejtuar nga Fryma e Shenjtë. Kur u transferuam në fillim në Kolegjin Qendror Biblik, ku bashkëshorti im do të punonte si president i tij, po linim pas drejtimin dhe udhëheqjen e një kishe të mrekullueshme. Krejt papritur, unë nuk e dija se ku saktësisht hyja unë në këtë rol të ri, si dhe kush do të ishin përgjegjësitë e mia. Siç e kam përmendur disa herë, mua më pëlqen të jem bashkëshortja e pastorit. Por të gjitha përgjegjësitë e çmuara si bashkëshortja e pastorit papritur nuk ishin më, sepse filloi detyra e shërbesës së re. Nuk e kisha humbur zemrën time prej pastoreje. Kështu, çdo mëngjes shkoja në kapelën e kolegjit dhe ndërsa nisja ditën time, i kërkoja Perëndisë të më drejtonte tek studenti ose individi që kishte nevojë për t’u shërbyer ose që thjesht kishte nevojë për një fjalë inkurajimi. Ka pasur shumë raste kur e kam ditur që po udhëhiqesha nga Fryma e Shenjtë për tek një person i caktuar, në një kohë të caktuar, për një arsye të caktuar. Gra të çmuara që jeni në shërbesë, kur Perëndia sheh zemra që mezi presin të jenë në shërbim të Tij, do të ketë patjetër mundësi të panumërta. Ato mund të jenë të paplanifikuara, mund të jenë të qëllimshme, ose mund të jenë të iniciuara nga Fryma, por

Si ndjekëse të Tij, bëni një përpjekje të qëllimshme për t'i arritur të gjithë njerëzit dhe për të ndarë “ujin e gjallë që ata të mos kenë më etje përsëri” (Gjo. 4:13).

Perëndia njeh zemrën tuaj të gatshme. Ekziston një botë e mbushur plot e përplot me njerëz përreth nesh të cilët mezi presin të gjejnë çlirim dhe paqe në rrethanat e tyre të dhimbshme. Ai do t'ju përdorë juve për të ndarë dashurinë e Jezusit.

Vetëm para disa ditësh ndjeva se duhet të merrja në telefon dikë që jeton në një shtet tjetër të Amerikës. Në fakt, ky person jeton disa qindra kilometra larg nesh. E ndërpreva atë që po bëja në atë çast dhe mora telefonin për t'i rënë numrit. Bashkëshorti i saj tha: "Ambulanca është rrugës për të marrë gruan time. Nuk e dimë se çfarë ka." E sigurova që ne do të luteshim menjëherë. Pa dyshim që rasti me këtë çift ishte një nga ato "takime hyjnore". Ata nuk kishin një marrëdhënie me Jezusin. Tani, edhe pse në një marrëdhënie të tillë të largët, letrat e tyre përfundojnë me "shpëtimtari im i dashur Jezu Krishti". Meqë ra fjala, ajo po përmirësohet goxha. Perëndia është kaq besnik.

Shpeshherë lutja ime ka qenë: "O Perëndi, me jep zemrën tënde të dashurisë. Me anë të Frymës sate, më lejo që të shoh përtej buzëqeshjeve, bisedave të rastit dhe të jem e ndjeshme ndaj një zemre të pikëlluar". Të gjitha ne, në një rast apo një tjetër, kemi nevojë për një fjalë inkurajimi. Bëhuni inkurajuese. Bëjini njerëzit të ndihen më mirë për shkak se kanë qenë me ju. Fjalët e Urta 16:24 thotë: "Fjalët e ëmbla janë si një huall mjalti, ëmbëlsi për shpirtin dhe ilaç për kockat."

Janë pikërisht këto marrëdhënie personale, zhvillimi i besimit dhe respektit që do ta çojë eventualisht personin t'ju hapet juve. Një pjesë tejet thelbësore në ungjillëzim dhe dishepullizim është formimi i marrëdhënieve që zgjasin. Ato do të vëzhgojnë mënyrën me të cilën përballeni me jetën, dhe me gjithë presionet dhe vështirësitë e saj. Nuk janë gjithmonë fjalët që dalin nga goja ime, por mund të jetë jeta ime në veprim. Në atë moment Fryma do t'ju drejtojë tek një zemër e hapur, e cila është gati të dëgjojë dhe të marrë. Ky "takim hyjnor" ndoshta nuk është fare takim, por dikush më pa në një rrethanë të vështirë dhe pa sesi Perëndia më ndihmoi që ta menaxhoja atë situatë. Madje, edhe pa njohurinë time, personi mund të ketë qenë duke kaluar nëpër një situatë të ngjashme dhe Perëndia me lejoji që të isha në atë vend të caktuar në atë kohë të caktuar për të qenë një ndikim në atë jetë.

Si fëmijë e Perëndisë, unë dua të jem vazhdimisht e

vetëdijshme rreth mundësive për të treguar për dashurinë e Tij në mënyra konkrete. Në fund të fundit, a nuk flasim që të gjitha rreth gjërave të cilat i duam shumë? Kështu që, nuk është e vështirë për ne që të flasim rreth domethënies që Krishti ka për ne. Para disa ditësh, isha në një dyqan dhe një grua më tha: "Ti gjithmonë buzëqesh dhe dukesh kaq e lumtur. Sa më pëlqen kur futesh në dyqan". Ndërsa po e shikoja duke i buzëqeshur, dhe me sy plot dashuri, i pëshpërita butësisht: "A e di pse?" I tregova me gisht zemrën dhe i thashë: "Sepse Jezusi jeton në zemrën time!". Jam kaq mirënjohëse për çdo rast që Perëndia më ndihmon të ndaj një dëshmi të mirë nga marrëdhënia ime me Të, qoftë me anë të fjalëve apo të veprave të mia. Por më duhet të rrëfej, se nuk është gjithmonë e lehtë. Ka ditë kur nuk ndihemi me aq humor të ngritur sa do të donim. Unë jam e bindur se fëmijët e Perëndisë së Plotfuqishëm duhet të jenë njerëzit më të lumtur në botë. Prandaj në ato ditë, unë numëroj bekimet e mia, falënderoj Perëndinë për shpëtimin time dhe për njohurinë se Ai ka në kontroll jetën time. Ai më do më shumë sesa do të mund ta imagjinoja. Ai është në dijeni të kësaj dite në jetën time dhe asnjë gjë nuk është "surprizë" për Të. A nuk është e mrekullueshme të jetosh për Jezusin?!

Të dashura gra, si fëmijë të përkushtuara të Perëndisë, ne kemi kaq shumë për të ofruar. Kemi dashurinë e Perëndisë. Kemi Fjalën e Tij që nuk ndryshon asnjëherë. Kemi Frymën e Shenjtë që jeton në zemrat tona. Qoftë kjo në shtëpitë tona së bashku me bashkëshortët dhe fëmijët tanë apo qoftë kur bëhet fjalë për fqinjët tanë të cilët shohin se si jetojmë. Mund të jetë në kishën ku drejtoni. Mund të jetë një treg, vendi ku Perëndia siguron një mundësi unike për të qenë një dëshmitar për Të. Shumë vite më parë, kam dëgjuar historinë e një zotërie i cili e mori një djalë të vogël me vete në treg për të dëshmuar rreth Jezusit. Kur kishin mbaruar me blerjet që duhet të bënin atë ditë, djali i vogël e pyet zotërinë: "Kur do të dëshmojmë?". Burri i përgjigjet: "Ne kemi dëshmuar kudo ku kemi shkuar".

Prandaj sfida ime sot për ju është që të jeni një dëshmitar kudo ku shkoni. Kjo është një ditë e re që Zoti jua ka dhënë. Bëhuni dhe qëndroni një dishepulle madhështore e Jezusit dhe shkoni që të "bëni dishepuj". Bekimet e Zotit qofshin me ju, zemrat tuaja u inkurajofshin dhe dashuria e Tij e mbushtë me bollëk zemrën tuaj.



MARCIA LEDNICKÝ është një folëse e shpeshtë nëpër seminare dhe konferenca për femra. Ajo ka një aftësi unike për t'i lidhur sfidat e jetës së përditshme me të vërtetat e Shkrimit. Shërbesa e saj e të folurit në publik rritet me anë të talentit të saj vokal të jashtëzakonshëm përmes të cilit ajo komunikon dhe transmeton dashurinë e Krishtit.



i Ungjillizimit dhe Dishepullizimit:

Kur Jezusi iu dha dishepujve të Tij Porosinë e Madhe, kjo nuk ishte një ide e re për ta. Përmes mësimit dhe shembullit të Tij, Jezusi i kishte përgatitur dishepujt e Tij për detyrën e tyre.

Misioni që ata kishin përpara nuk ishte thjesht që të mbledhnin një tjetër lëvizje shoqërore fetare. Ata duhej të ishin pjesëmarrës në aktivitetin hyjnor të Perëndisë në botë, duke e shpënuar njerëzimin e humbur për Zotin. Ashtu siç kishin parë bukët dhe peshqit të shumoheshin, tanimë dishepujt do të merrnin pjesë në përjetësimin dhe shumëfishimin e mesazhit që Jezusi iu kishte besuar.

Secili prej katër ungjijve mbyllet duke e vënë theksin tek misioni të cilin Jezusi ua besoi dishepujve të Tij në fund të shërbesës së Tij në tokë. Vargjet e Porosisë së Madhe në të tre ungjijtë sinoptikë, si edhe tek ungjilli i Gjonit, paraqesin në mënyrë të qartë një mision tërësor që përfshin ungjillëzimin dhe dishepullizimin.

Një përkufizim i saktë dhe i hollësishëm i ungjillëzimit është dhënë nga Uilliam Tempëll (William Temple), i cili ishte kryepeshkopi i 98-të i Kanterberit (1942-44): "Ungjillëzim do të thotë që ta paraqesësh Jezu Krishtin në fuqinë e Frymës së Shenjtë, në mënyrë që njerëzit të mund t'i besojnë Atij si shpëtimtar dhe t'i binden Atij si Zot në bashkësinë e kishës së Tij".

Trajtimi i ungjillëzimit dhe dishepullizimit veç e veç

është një dallim artificial. Ashtu siç nuk mund të vendosim një kufi mes ngjyrave të një ylberi, po ashtu edhe ungjillëzimi në Shkrim nuk mund të ndahet nga dishepullizimi. Ungjillëzimi dhe dishepullizimi nuk janë dy pjesë të një progresi që fillon me ungjillëzimin dhe kulminon me dishepullizimin. Përkundrazi, ata përbëjnë një cikël. Ungjillëzimi duhet të ndërmerret duke pasur dishepullizimin si objektiv, dhe dishepullizimi duhet t'i përgatisë besimtarët për ungjillëzim.

Ungjillëzimi Para Dishepullizimit

Në shëmbëlltyrën e mbjellësit, Jezusi dha mësim se fara, Fjala e Perëndisë, ose mesazhi, do të bjerë në lloje të ndryshme tokash. Disa nga njerëzit që do të dëgjojnë mesazhin, nuk do të përgjigjen, ndërsa disa që do të përgjigjen, nuk do të qëndrojnë në të.

Disa persona i përqasen shëmbëlltyrës së mbjellësit nga një perspektivë negative për shkak se tri nga katër llojet e dheut nuk arrijnë të prodhonin jetë që zgjat, por shëmbëlltyra sheh përtej këtyre pengesave tek triumfi i Fjalës së Perëndisë në prodhimin e mbretërisë së Perëndisë. Megjithatë shumë hapësirë tek shëmbëlltyra i kushtohet renditjes së tri llojeve të tokës të cilat nuk janë prodhuese, vetëm një pjesë e vogël e farave do të binin në këto vende në një arë. Shëmbëlltyra nuk nënkupton se mbjellësit i shkon dëm shumica e punës së tij.



Një Proces Pa Mbarim

Nga: **RANDY HURST**

Në pjesën më të madhe të shpjegimeve të saj, shëmbëlltyra e mbjellësit trajtohet si të ketë katër lloje dhe: tokë e fortë, tokë e cekët, tokë me ferra dhe tokë e mirë. Por, shëmbëlltyra mund të shihet edhe sikur paraqet dy lloje dhe: prodhues dhe joprodhues. Për secilin prej këtyre dy llojeve të dheut janë dhënë tre shembuj. Çdo person përballet me një nga këto dy destinacione. Rezultati i ungjillëzimit ka të bëjë me tokën e mirë, me ata tek të cilët jeta jo vetëm që fillon, por gjithashtu edhe rritet e shumëfishohet.

Disa njerëz i përqasen ungjillëzimit me objektivin e vetëm për të parë një jobesimtar që të bëjë lutjen e mëkatarit. Por qëllimi i ungjillëzimit është më i madh sesa një vendim shpëtimi. Qëllimi i ungjillëzimit është një ndryshim në stilin e jetesës: një person që ndjek Krishtin duke iu bindur mësimave dhe urdhërimeve të Tij. Objektivi përfundimtar është një *dishepull*: një ndjekës i përkushtuar dhe besnik i Krishtit.

Fatkeqësisht, në qoftë se një person mbërrin tek një vendim shpëtimi pa kuptuar çmimin që ka të ndjekësh Krishtin, ai mund ta fillojë mirë, por nuk do të vijojë që ta ndjekë dhe t'i shërbejë Atij. Kjo situatë është e ilustruar nga tri llojet e para të dheut që përmenden tek shëmbëlltyra e mbjellësit. Njerëzit e marrin mesazhin, por zogjtë ua rrëmbejnë farën, dielli e djeg atë ose e mbysin ferrat. Jezusi shpjegoi se zogjtë, dielli dhe ferrat përfaqësonin pengesat në jetët frymërore të njerëzve. Kjo përfshin persekutimin ose dëshirën

për pasuri. Këto nuk e lejojnë mesazhin që të ketë një ndikim afatgjatë.

Pavarësisht se sa me pasion dëshirojmë që t'i shohim njerëzit teksa marrin vendime për Krishtin, më shumë mundësi ka që t'i detyrojmë ata që të ndërmarrin vendime të parakohshme (të nxituara) në vend që të bashkëpunojmë me Frymën e Shenjtë sipas udhëheqjes së Tij; së pari tek një vendim, dhe më pas, drejt dishepullizimit.

Ndërgjegjësimi se dishepullizimi duhet të jetë objektivi i ungjillëzimit, do të ndikojë tek mënyra se si e përcjellim mesazhin. Jezusi dha si mësim se ndjekësit e Tij duhet të kuptojnë çmimin e të qenit dishepujt e Tij: "Dhe kush nuk e mbart kryqin e vet dhe nuk vjen pas meje, nuk mund të jetë dishepulli im. Sepse kush nga ju, pra, kur do të ndërtojë një kullë, nuk ulet më parë të llogaritë shpenzimet, për të parë nëse ka sa i duhen për ta mbaruar?" (Luka 14:27,28).

Një jobesimtar duhet të kuptojë domethënien e vendimit për të pranuar faljen e Krishtit dhe për ta ndjekur Atë. Besimtarët duhet të jenë të kujdesshëm që të mos i manipulojnë emocionalisht njerëzit për të marrë vendime të cilat ata as nuk i kuptojnë e as nuk janë gati t'i marrin. Kur lutemi me një person për të pranuar Krishtin, duhet të sigurohemi që personi e kupton atë që po bën. Kjo kërkon urtësi dhe ndonjëherë madje edhe vetëpërmbytje.

Ashtu siç kishin parë bukët dhe peshqit të shumoheshin, tanimë dishepujt do të merrnin pjesë në përjetësimin dhe shumëfishimin e mesazhit që Jezusi iu kishte besuar.

Nuk jemi ne përgjegjësit për t'i bindur njerëzit që t'ia përkushtojnë jetët e tyre Krishtit. Ungjillëzimi nuk është thjesht përpjekje njerëzore për të bindur; është vepër e Frymës së Shenjtë. Jezusi premtoi se Fryma e Shenjtë do ta bindte botën në lidhje me mëkatën, me drejtësinë dhe me gjyqin (Gjoni 16:8). Ne jemi përgjegjës për ta përcjellë mesazhin në mënyrë të qartë. Por Fryma e Shenjtë e bind dhe e nxit zemrën e dëgjuesit. Kur e kuptojmë se Perëndia merr iniciativën dhe qëndron aktiv në procesin e ungjillëzimit, atëherë kjo na aftëson që të jemi të guximshëm, duke u mbështetur në punën e Tij bindëse. Gjithashtu mund të jemi të duruar, duke i besuar kohës së Tij në vend që të përpiqemi t'i shtyjmë njerëzit drejt një vendimi të nxituar. Kjo na lejon që të mos jemi as hezitues e as të nxituar me dëshminë tonë.

Dishepullizimi Para Ungjillëzimit

Cikli i ungjillëzimit dhe i dishepullizimit përmbushet kur dishepujt bëhen lajmëtarë të cilët ungjillëzojnë dhe bëjnë më shumë dishepuj.

Në këtë aspekt, kisha në Perëndim mund të mësojë nga kisha në pjesët e tjera të botës. Gjatë 50 viteve të fundit, rritja e kishës në bashkësitë e Asambleve të Perëndisë në shumë vende e ka tejkaluar mjaft rritjen në Perëndim. Kjo është veçanërisht e vërtetë në Amerikën Latine, në Afrikë dhe në disa pjesë të Azisë. Një nga arsytet për këtë rritje shpërthyes e eksponenciale është që në shumicën e vendeve të Botës së Tretë besimtarët janë mësuar që të ungjillëzojnë dhe prej tyre pritet që ta bëjnë këtë gjë. Shumica e besimtarëve në Amerikë presin nga stafi profesional dhe i paguar i kishës që ta bëjë ungjillëzimin. Në ato vende të cilat nuk kanë një numër të konsiderueshëm stafi të paguar kishë, bashkësitë janë shumë më aktive në ungjillëzim.

Të qenit një dëshmitar efikas nuk varet domosdoshmërisht nga vitet që një person ka ndjekur Krishtin dhe as madje se sa i pjekur është nga ana frymërore. Një hulumtim i gjerë, në mijëra kisha, tregon se pjesa më e madhe e ungjillëzimit personal në një bashkësi të caktuar bëhet nga personat që kanë më pak se një vit që janë bërë të krishterë.

Ungjillëzimi personal është një pjesë thelbësore e të ndjekurit të Krishtit. Ai duhet të jetë pjesë e stilit të jetës së secilit besimtar, për të pasur një impakt tek jobesimtarët përreth tij.

Objekti

Objekti i ungjillëzimit dhe i dishepullizimit përshkruhet qartësisht në Letrën e Palit Drejtuar Kolosianëve. "Tani ju pajtoi në trupin e mishit të tij, me anë të vdekjes, që t'ju paraqesë përpara vetes së tij të shenjtë, të patëmetë dhe të paqortueshëm, në qoftë se qëndroni në besim të themeluar dhe të patundur dhe të mos luani nga shpresa e ungjillit" (Kol.1:22, 23). Më tej, Pali përshkruan objektivin e shpalljes së ungjillit: "që ne e kumtuam, duke e paralajmëruar dhe duke e mësuar çdo njeri me çdo urtësi, që ta paraqesim çdo njeri të përsosur në Krishtin Jezus" (Kol.1:28). Vini re se qëllimi është që çdo dishepull të paraqitet përpara Zotit i shenjtë, i patëmetë dhe i paqortueshëm, i përsosur në Krishtin Jezus, në fund të jetës mbi tokë.

Shpesh pastorët, ndërsa udhëheqin kishat vendore në ungjillëzim, do të duhet që të marrin vendime të cilat kanë të bëjnë me mënyrën se si do të shpenzohen koha dhe burimet. Edhe ne, si Pali, duhet të përkushtohemi për të ungjillëzuar "*me çdo mënyrë*" (1 Kor. 9:22). Por na duhet t'u japim përparësi atyre mënyrave që rezultojnë në objektivin përfundimtar të përkufizuar nga Fjala e Perëndisë: dishepuj të cilët janë "të përsosur në Krishtin Jezus" (Kol.1:28). Ndonjëherë kjo do të nënkuptojë që të zgjedhim metoda që mund të mos prodhojnë shumë vendime fillestare, por që do të rezultojnë në më shumë dishepuj.

Shqetësimi i Jezusit fokusohet tek pasojat e përjetshme të mëkatit dhe tek destinacioni i përjetshëm i secilit person. Ungjilli i bën thirrje çdo dëgjuesi që të vendosë dhe t'i përgjigjet shpalljes së Fjalës së Perëndisë. Fokusi i ungjillit është tek shpëtimi i individëve që do të përbëjnë nusen e Krishtit. Misioni i kishës është që të marrë pjesë në misionin e Krishtit për të "çuar shumë bij në lavdi" (Heb.2:10). Cikli i ungjillëzimit dhe i dishepullizimit është një proces pa mbarim i arritjes dhe mbajtjes së njerëzve, të cilët bëhen qytetarë të mbretërisë së përjetshme të Krishtit.



RANDY HURST, Springfield, Misuri, është drejtori i komunikimit për Misionet në Botë të Asambleve të Perëndisë, si dhe komisioner në Komisionin mbi Ungjillëzimin.

PËRSHTYPJE NGA KONFERENCA BALLKANIKE E TË RINJVE

Nga: PASTOR GËZIM SPAHIJA

MISION PER BALLKANIN



Jacob & Julie Bock

Misionarë të Asamblesë së Perëndisë në Amerikë
Prej 31 vjetësh , Misionarë në Spanjë,
Madrid, që nga viti 1985

"Shko, sepse ai është vegla që Unë kam zgjedhur për ta sjellë emrin Tim..."
Veprat 9:1

Me padurim për të ardhur në këtë ditë të fillimit të konferencës së Misionit për Ballkanin, qindra të rinj e të reja u mbledhën nga vende të ndryshme, nga data 3 deri më 5 qershor, 2016, në Durrës. U mbledhën për t'u takuar së bashku, për të treguar, dhe për të marrë më shumë rreth vizionit të Perëndisë për Ballkanin. Konferenca e tretë kjo – dhe për ata që kishin qenë pjesëmarrës edhe në konferencat e tjera, lexohej një kënaqësi e veçantë në sy, teksa takoheshin me motra e vëllezër të tjerë.



Kurioziteti dhe nevoja e të gjithëve ishte që të merrnin më shumë informacion, dëshmi, dhe mënyra se si Perëndia po vepron dhe po i bekon misionarët që janë atje, duke shërbyer në fushën e misionit në Ballkan. Kjo u shpall fuqishëm nga misionarët tanë që shërbejnë atje, por edhe nga të ftuar nga vende të tjera të Ballkanit, dhe emëruesi i përbashkët ishte nevoja për më shumë njerëz me zemër dhe përkushtim për shërbesë në fushën e misionit. Ky ishte edhe qëllimi kryesor i kësaj konference: që Zoti të thërrasë sa më shumë të rinj me dëshirë për të shërbyer në fushën e misionit, si dhe të nxisë iniciativa të ndryshme në lidhje me këtë fushë.

Tema e Konferencës ishte: **“Shko, sepse ai është vegla që unë kam zgjedhur për ta sjellë emrin tim”**, Veprat 9:15. Ajo çfarë ishte kërkuar nga folësi, Jacob Bock, misionar në Spanjë, ishte që ai ta sillte të gjallë këtë thirrje si zëri i profetit për popullin e tij, gjë të cilën ai e realizoi më së miri. Le të lutemi që fara e mbjellë në këtë konferencë të japë fryte.



Jehona e konferencës ka vazhduar gjatë dhe kjo duket përmes prekjes në zemër që kanë ndjerë shumë besimtarë. Kjo është evidentuar edhe përmes komenteve të ndryshme që vëllezër e motra vazhdojnë të na dërgojnë në lidhje me të, si:

“Pjesëmarrja në këtë konferencë më ka ndryshuar krejtësisht e në të gjitha drejtimet konceptin në lidhje me misionin, pasi mendoja që ai ishte vetëm pjesë e angazhimit të disave, të cilët kishin një përgjegjësi në lidhje me të”.

“U njoha me të rinj të cilët, të mbushur plot me dëshirë e guxim, janë duke lëvizur në fushën e misionit”.

“Zoti mbollti një farë tek mua në këtë konferencë në lidhje me shërbesën e misionit”.

“Investimi më i sigurt i parave të mia është fusha e misionit”.

“Mendova se nuk ka më vend në zemrën time për një komb tjetër, se ajo është plot. Zoti ma zgjeroi zemrën dhe krijoi hapësirë që edhe Ballkani të jetë në të”.

“Zoti vendosi si një zjarr në zemrën time dëshirën për t’u lutur çdo ditë për misionarët”.

Konferenca të tilla janë shumë inkurajuese, jo vetëm për drejtuesit apo për ata që kanë dëshirë për të shërbyer në fushën e misionit, por edhe për të gjithë kishën. I bekuar, i thirrur, i privilegjuar është ai që bëhet pjesë e misionit të Krishtit, për të arritur zonën e Ballkanit si pjesë të mbretërisë së Perëndisë.



Pastor GËZIM SPAHIJA,
Drejtor Ekzekutiv i KPAPSH



KOLEGJI TEOLOGJIK UNGJILLOR

...sepse Perëndia i të korrave vazhdon të thërrasë punëtorë!



Pastor, a keni nevojë që të zhvilloni bashkëpunëtorë frymërorë dhe të aftësuar në kishën tuaj? Lejoni që KTU të ndihmojë! KTU ekziston që...

- të përgatisë mbjellës kishash, pastore, misionarë dhe shërbëtarë të tjerë me dijen e Fjalës së Perëndisë dhe një shërbesë të efektshme në një kontekst pentakostal
- të mësojë teologji të shëndoshë dhe të zhvillojë udhëheqës shërbëtorë
- të avancojë ungjillin dhe të themelojë kisha pentakostale dhe të tjera ungjillore midis shqiptarëve dhe më gjerë në të tërë botën

...dhe është duke e përmbushur këtë qëllim. Pas dhjetë vitesh investimi në përgatitjen e shërbyesve, jemi duke parë frute. Pesëdhjetë të diplomuar janë duke ndikuar për Krishtin në shumë vende të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe në kombe të tjera jashtë vendit.

Në KTU, studentët do të mësojnë rëndësinë e formimit transformues të karakterit, të jetës së krishterë në komunitet, doktrinës së shëndoshë, mësimi të mirë biblik, teologjik, misionologjik, si dhe përgatitjes së balancuar dhe serioze për shërbesë. KTU nuk është një shkollë dishepullizimi për besimtarë të rinj. Kjo është një shkollë biblike e një niveli universitar për ata që janë të thirrur për shërbesë.

Dërgimi i një studenti në KTU kërkon besim, përkushtim dhe sakrificë, por ju garantojmë që ia vlen të investosh. A dëshironi që shërbesa juaj të rritet? Atëherë mbillen farën në trainim. Në drejtues-misionar ka thënë, *"Ai që trainon më shumë, korr më shumë shpirtëra të humbur."* Bëni një hap besimi dhe do të shikoni çfarë Perëndia do të bëjë!

Për më shumë informacion, kontaktoni:

ktu@icc-al.org ♦ Cel.: 069 406 8956